

NATURAL  
POOL&SPA



@NATURAL POOL&SPA



WWW.NATURAL-KS.COM



+38348473473



SOJEVË, FERIZAJ

TRAVEL MAGAZINE

SHKURT - MARS 2025

# GP MAGAZINE

AIRPLANE MAGAZINE

Muaji i Epopesë  
së UÇK-së

Çka importon e  
çka eksporton  
**Kosova?**

*Teleskopi*  
gjigant nga i  
cili vëzhgohen  
planetët

Rrugëtimi i  
artë drejt  
Olimpiadave

*Aviacioni:*  
**MUNDËSI PUNËSIMI  
DHE ZHVILLIMI  
PËR KOSOVËN**

REPORTING  
HOUSE

VIZITONI MUZEUN "REPORTING HOUSE"

HYRJA FALAS

E MARTË - E SHTUNË | 10:00<sup>H</sup>-16:00<sup>H</sup> | LOKACIONI: ISH-SHTËPIA E MALLRAVE GËRMIA, TE SKËNDERBEU



**20**

**YEARS TOGETHER**



# FJALA E BOTUESIT

Të dashur lexues,

Ky numër festiv i dedikohet suksesit në ndërtimin e Pavarësisë së Kosovës.

Vizitorët e rinj të vendit tonë do të gjejnë në këtë numër historinë e re të shpalljes së pavarësisë.

Do të kenë mundësi të lexojnë për ngjarjet atraktive që ndodhën dhe do të mësojnë për sukseset që vendi i ka pasur gjatë 17 viteve si shtet.

Rrugëtimi i ndërtimit të shtetit ishte i gjatë dhe me shumë sakrificë. Vizitorëve të vendit tonë do t'u tregojmë për historitë dhe vendet që duhet të vizitohen për të kuptuar historinë e Kosovës.

Prindër të dashur, edhe në këtë numër kemi dedikuar hapësirë ku mësuesit me përvojë do t'ju këshillojnë për edukimin kombëtar të fëmijëve që rriten në diasporë.

Ekipi ynë, me mësuesit profesionistë të diasporës, ju ka përgatitur këshilla të rëndësishme që duhen ndjekur.

Fluturimet me ne janë atraktive dhe ju mund të shfrytëzoni kohën duke u lexuar fëmijëve tuaj përrallat e bukura shqipe që i kemi përgatitur edhe në këtë numër.

Përrallat që ju servojmë në këtë numër do t'u mbeten në kujtesë fëmijëve tuaj dhe janë mundësi për t'i ritreguar brez pas brezi.

Potencialët turistike të Ballkanit do të jenë të eksploruara edhe në këtë numër, ndërsa, duke ju sjellë rrëfime për sukseset e bizneseve në Kosovë, synojmë t'ju japim një anë tjetër të medaljes për vendin.

Do t'ju ofrojmë këshilla për potenciale investive dhe do të promovojmë hapësira në të cilat mund të gjeni punësim në Kosovë dhe mundësi për të investuar paratë tuaja.

Bota është e vogël dhe, si në çdo numër tjetër, do t'ju sjellim rekomandimet për vendet që duhet të vizitoni gjatë shkurtit dhe marsit. Në sezonin e dimrit, pa dyshim, do t'ju këshillojmë për rivierën turistike të Ballkanit dhe zonat e bukura të Kosovës.

*Ju urojmë udhëtim të këndshëm!  
Urime 17 vjet shtet!*



Adresa: Prishtinë, Mati 1. nr.31  
Tel: +383 44 326 143  
E-mail: service@gp-aviation.net



# LEXONI NË KËTË NUMËR



## 05

Rrugëtimi i artë drejt olimpiadave

## 08-09

Aviacioni: Mundësi punësimi dhe zhvillimi për Kosovën



**FAQE 16-17** Teleskopi gjigant nga i cili vëzhgohen planetët

**FAQE 20-23** Nga fabrikat moderne deri te prodhimi cilësor, si prodhohet qumështi i Kosovës

**FAQE 38-39** Prodhimi i veshjeve nga kreatorët e Kosovës

**FAQE 42-43** Turizmi familjar që po ndërtohet në Rugovë

**FAQE 54-55** Këndi i mësuesit të diasporës

**FAQE 64-65** Këndi i përrallave të fëmijëve





# RRUGËTIMI I ARTË DREJT OLIMPIADAVE

**G**jashtë vjet pas shpalljes së pavarësisë, Kosova u pranua në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar. Data 9 dhjetor 2014 është dita kur Kosova u bë anëtare e Komitetit Olimpik, vendim ky që i hapi rrugë garave në Lojërat Olimpike Botërore. Në rrugëtimin 10-vjeçar, sportistët olimpikë të Kosovës arritën të fitojnë 5 medalje olimpike. Këto medalje e rendisin Kosovën shumë më lart se vendet e rajonit, të cilat gjatë kësaj kohe nuk arritën të fitojnë medalje.

## **Në tri garat olimpike, historia nisi me Majlinda Kelmendin.**

Xhudistja nga Peja, Majlinda Kelmendi, është sportistja e parë që u stolis me medalje të artë në emër të Republikës së Kosovës. Ajo fitoi medaljen e artë në Lojërat Olimpike të Rio 2016.

Katër vjet më vonë, në vitin 2020, dy sportistet e tjera, Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi, u stolisën me dy medalje të arta në xhudo.

Katër vjet më vonë, në Lojërat Olimpike të Parisit 2024, dy sportistet, Distria Krasniqi dhe Laura Fazliu, u stolisën me medaljet e argjendta dhe të bronzta.

## **Rrugëtimi i anëtarësimit në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar**

Sportistët nga Kosova kishin garuar në Lojërat

Olimpike në kuadër të ish-Jugosllavisë.

Pas heqjes së autonomisë së Kosovës, në vitin 1989, sportistët nga Kosova refuzuan të garonin në emër të Serbisë apo të Jugosllavisë.

Në kushte të vështira, sportistët synuan të mbanin gjallë sportin dhe të krijonin mundësi për të rinjtë për të garuar. Në kuadër të institucioneve, të themeluara pas vitit 1990, u themelua edhe Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK).

Komiteti Olimpik i Kosovës u themelua më 27 maj të vitit 1992. Kishte shpresë – apo më e drejtë kishte ëndrra – që Kosova mund të lejohej të garonte në Lojërat Olimpike Verore “Barcelona 1992”, të mbajtura prej 25 korrikut deri më 9 gusht të atij viti.

Por, pas Barcelonës, në vitin 1992, u mbajtën edhe pesë edicione të Lojërave Olimpike Verore pa Kosovën pjesë të tyre. Që prej anëtarësimit, Kosova është anëtare me të drejta të plota në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar. Njëri nga sukseset më të mëdha është vendimi që Kosova të organizojë Lojërat Olimpike Mesdhetare në vitin 2030. Këto gara priten të jenë ngjarja më e madhe sportive që ka ndodhur në historinë e Kosovës.

# Promobi

www.promobi-ks.com



NEW ARRIVALS

Ofertat më të mira  
për interier modern!

Magjistranja Ferizaj - Prishtinë

+38345999102

+38344478660



Jepni një dizajn unik shtëpisë tuaj me mobiljet tona të cilat i sjellim për ju kudo në Europë!



### **Mesazhi i GP Aviation**

*Të dashur udhëtarë, mirë se vini në bordin e GP Aviation,  
Me besimin tuaj, kompania jonë po rritet dhe bashkë me të edhe  
ekonomia e Kosovës.*

*Ky është viti i pestë prej kur kompania jonë operon me linjat e  
drejtpërdrejta nga Prishtina në drejtim të botës.*



***Mbi vizionin e themeleve të kompanisë, ne po vazhdojmë të rritemi, duke shtuar numrin e personelit, numrin e operimeve, dhe numrin e flotës sonë ajrore. Vizioni ynë është i qartë: Prishtina do të jetë qendër e operimeve të sigurta dhe të përballueshme ajrore.***

***Flota jonë ajrore përbëhet nga avionë si: Boeing 737-400, Airbus 320, Airbus 319.***

***GP e nis vitin 2025 me një plan ambicioz të shtimit të numrit të operimeve dhe, bashkë me ju, do të thyejmë rekorde të reja***



*Aviacioni:*

# MUNDËSI PUNËSIMI DHE ZHVILLIMI PËR KOSOVËN

**B**ordi i aeroplanëve të GP Aviation është shndërruar në një motor të zhvillimit të punësimit në Kosovë dhe të ofrimit të mundësive për ekonominë e vendit.

Si kompania me më së shumti operime në Aeroportin e Prishtinës, GP Aviation ka arritur të punësojë dhjetëra të rinj e të reja entuziastë nga Kosova, të cilët shërbejnë në bordin e avionit dhe në shërbimet mbështetëse të kompanisë.

Aktualisht, në bordin e aeroplanëve të GP Aviation shërbejnë rreth 50 anëtarë të ekuipazhit, të cilët kujdesen për mbarëvajtjen e fluturimeve, si stjuardë dhe stjuardesa. Të rinjtë nga Kosova, që janë bërë pjesë e ekipit, kanë ndjekur trajnimet më të avancuara të aviacionit dhe janë certifikuar për

ushtrimin e profesionit.

Rritja e fluturimeve dhe numrit të udhëtarëve ka nxitur edhe më tej nevojën për shtimin e stafit dhe GP Aviation tashmë është duke e trajnuar gjeneratën tjetër të të rinjve që do t'u bashkohen bordeve të avionëve tanë.

Industria e aviacionit mbështetet nga ekipe të tjera që operojnë nga toka dhe punësojnë të rinj të tjerë entuziastë në Kosovë, përfshirë operimet në qendrat e thirrjeve (call center) dhe shërbimet e tjera.

Me rreth 1 milion udhëtarë në vit, bordi ynë është një konsumues gjigant i prodhimeve ushqimore dhe të pijeve.

Kateringu i GP Aviation është një nga përkrahësit më të mëdhenj të prodhuesve vendorë nga Kosova.

**FMO**  
**Prishtinë**  
disa herë në javë

**FMO**

**FLUGHAFEN  
MÜNSTER  
OSNABRÜCK**





### RC Cola

RC Cola është një nga produktet vendore më të njohura në Kosovë. Kjo pije, e cila shitet në disa shtete, prodhohet me licencë amerikane nga kompania "Royal Crown Cola", ndërsa baza e prodhimit ndodhet në Rajonin e Gjilanit.



### Lëngjet Jaffa

Fabrika e lëngjeve Jaffa është e bazuar në Rajonin e Gjilanit, ndërsa produktet e saj janë të certifikuara sipas standardeve ISO 22000:2005 dhe HACCP. Pijet e prodhuara për tregun e Kosovës eksportohen në Zvicër, Suedi, Danimarkë, Norvegji, Gjermani, Itali dhe Amerikë.



### Go+

Në bordin e GP Aviation mund të konsumoni edhe pijen vendore energjike Go+. Kjo pije prodhohet në linjat moderne të fabrikës së Birrës Peja në Pejë, sipas standardeve të certifikuara të prodhimit.

## PRODUKTET VENDORE NË BORDIN TONË



### Birra Peja

Birra Peja është njëra nga birrat më cilësore që prodhohen në Rajonin e Ballkanit. Birra, e prodhuar me cilësi të lartë në fabrikën e birrës në Pejë, shpërndahet në të gjithë rajonin dhe është ndër birrat më cilësore në Ballkan.



### Prodhimet Sempre

Fabrika e prodhimit të biskotave Sempre është një brend kosovar i certifikuar dhe i njohur ndërkombëtarisht. Produktet e Sempre janë të dashura për fëmijët dhe të rriturit adhurues të biskotave.



### Produktet Doleo

Në bordin e aeroplanit tonë gjeni edhe produktet e brendit Doleo. Fabrika e prodhimit, e vendosur në fshatin Trudë, prodhon dhe përpunon ushqime të shijshme si MIX klasik apo kikirikon Doleo.



### Verërat Stone Castle

Kosova është ndër prodhuesit cilësorë të verërave. Nga vreshtat e Rahovecit, verëria Stone Castle prodhon verëra cilësore që eksportohen në dhjetëra vende të botës.



### Chipsat "Made in Kosova"

Fabrika e prodhimit të chipsave Vipa është një nga brendet më të njohura në Ballkan për prodhimin e chipsave. Kompania, e bazuar në Vushtrri, prodhon chipsa që eksportohen në shumë vende evropiane.



### Shkopinjte Sedefi

Një nga produktet më të dashura në tregun e Kosovës janë edhe shkopinjte Sedefi. Fabrika e prodhimit ndodhet në fshatin Vitomericë dhe prodhon dhjetëra produkte të cilësisë së lartë. Sedefi është një produkt i certifikuar.

# 17 Vitet e

## Pavarësisë së Republikës



**N**ë muajin shkurt, Kosova feston 17-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së vendit. Tetë vjet pas përfundimit të luftës, institucionet e krijuara me zgjedhje të lira kishin arritur të përgatisnin vendin për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës. Procesi i shpalljes së pavarësisë u quajt i koordinuar, pasi shpallja e pavarësisë kryhej nën pakon e hartuar nga ish-presidenti Martti Ahtisari. Ky i fundit udhëhoqi një proces dialogu në Vjenë, i cili rekomandoi një proces të një pavarësie të kushtëzuar, e cila pas shpalljes do të kishte një mbikëqyrje ndërkombëtare për disa vjet.

**Mbi zotimin që shteti i ri do të respektonte paketën e Ahtisarit, më 17 shkurt 2008 deputetët e Kuvendit të Kosovës u mblodhën për të shpallur Pavarësinë e Kosovës.**

Dokumenti i shpalljes së pavarësisë u lexua nga kryeministri i atëhershëm, Hashim Thaçi, ndërsa kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, dhe presidenti

Fatmir Sejdiu, ishin të pranishëm gjatë ceremonisë. Deklarata e pavarësisë, e nënshkruar nga deputetët e Kuvendit, theksoi vullnetin e popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi, duke u bazuar në Planin e Ahtisarit.

### ***Në historinë 17-vjeçare të shtetndërtimit, Kosova pati disa momente kryesore:***

**18 shkurt 2008:** Pa u mbushur 24 orë nga shpallja e pavarësisë, presidenti i ShBA-së, George W. Bush, u paraqit në një konferencë për media, në të cilën njoftoi se ShBA-ja e kishte njohur shtetësinë e Kosovës. Atë ditë, Kosova u njoh edhe nga Britania e Madhe, Gjermania dhe shumë shtete të tjera. Sipas regjistrimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Kosova ishte njohur nga 119 shtete të botës.

**15 qershor 2008:** Njëri nga aktet më kulminante të pavarësisë së vendit ishte miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Më 15 qershor, deputetët e Kuvendit miratuan Kushtetutën, e cila vendoste bazat kryesore të shtetit të Kosovës.

**22 korrik 2010:** Në korrik të vitit 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë konstatoi se shpallja e Pavarësisë së Kosovës nuk e shkelte të drejtën

# BOBORN

ndërkombëtare. Ky vendim ishte njëra nga fitoret më të mëdha diplomatike për Kosovën.

**7 shtator 2012:** Katër vjet pas shpalljes së pavarësisë, Kuvendi i Kosovës, në pajtim me partnerët ndërkombëtarë, shpallën ndryshimet kushtetuese, të cilat i jepnin fund pavarësisë së mbikëqyrrur të vendit. Ky vendim formalizoi në tërësi shtetësinë e Kosovës.

**Anëtarësimet në federata:** Për disa vjet me radhë, Kosova u sfidua nga mosnjohja e anëtarësisë së saj në federatat sportive dhe në Komitetin Olimpik Botëror. Më 13 maj 2016, Kosova u bë anëtare e FIFA-s, ndërsa më 9 dhjetor 2014 Kosova u anëtarësua në Komitetin Olimpik. Gjatë rrugëtimit të saj, tashmë Kosova është anëtare e të gjitha federatave dhe platformave sportive.

**14 dhjetor 2018:** Njëra nga ngjarjet e rëndësishme në ndërtimin e shtetit të Kosovës ishte vendimmarrja për të themeluar Ushtrinë e vendit. Në dhjetor 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për transformimin e FSK-së në ushtri të rregullt, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të kapaciteteve mbrojtëse.

**1 janar 2024:** Pas përmbushjes së udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, më 18 prill 2023, Parlamenti Evropian dha dritën e gjelbër për heqjen e vizave për Kosovën. Ky vendim nënkupton se qytetarët e Kosovës, që mbajnë pasaporta biometrike, do të mund të udhëtojnë pa viza në zonën Schengen deri në 90 ditë brenda një periudhe prej 180 ditësh. Vendimi hyri në fuqi më 1 janar 2024.

## DEKLARATA E PAVARËSISË

Deklarata origjinale e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës është shkruar në pergamenë, një lëkurë që përpunohet me ngjyra. Teksti i deklaratës u vendos në pergamenë nga grafisti Shyqri Nimani. Teksti, të cilin do ta shkruante, Nimanit iu dha vetëm një ditë para se të shpallej Pavarësia dhe atë në orën 21:30 të mbrëmjes. Ai kishte qenë personi i shtatë që kishte lexuar tekstin e Deklaratës.

## FLAMURI I KOSOVËS

Flamuri i Kosovës u zgjodh në një konkurs të hapur, ndërsa projekti i përzgjedhur u miratua nga deputetët e Kuvendit të Kosovës ditën kur u shpall pavarësia. Flamuri u dizajnuar nga Muhamer Ibrahim, sipas shpjegimit të disenjatorit. Flamuri ka një simbolikë, sipas së cilës yjet paraqesin komunitetet që jetojnë në Kosovë. Kosova paraqitet me një ngjyrë ari, pasi është një vend i pasur me resurse dhe ka një popullsi të re, ndërsa ngjyra e kaltër janë aspiratat e Kosovës dhe të qytetarëve të Kosovës për t'u integruar në institucionet euroatlantike.

## MONUMENTI I PAVARËSISË

Pak orë pas shpalljes së pavarësisë, liderët e vendit inauguruan në Prishtinë monumentin e pavarësisë "Newborn". Kjo vepër arti, e krijuar nga disenjatori Fisnik Ismajli, u bë simboli i pavarësisë së vendit, ndërsa mori disa çmime në gara ndërkombëtare. Monumenti i pavarësisë është një nga atraksionet e Prishtinës, para të cilit janë fotografuar qindra-mijëra qytetarë.

# GRATË MË TË SHKOLLUARA SE BURRAT


**R**egjistrimi i popullsisë, i realizuar në vitin 2024 në Kosovë, ka nxjerrë të dhëna interesante lidhur me edukimin gjinor në Kosovë. Ky regjistrim ka konfirmuar se gratë janë më të shkolluara në nivelin akademik sesa burrat. Të dhënat e ASK-së tregojnë se në Kosovë janë 88 mijë gra të shkolluara me nivelin bachelor. Sipas kësaj statistike, rreth 7 mijë gra më shumë se burrat e kanë përfunduar fakultetin. Edhe në studimet postdiplomike gratë janë më të suksesshme. Sipas ASK-së, në Kosovë janë 20 mijë burra që kanë përfunduar studimet postdiplomike dhe 22 mijë gra. Dallimi sa i përket gjinisë vazhdon të mbetet në studimet e doktoratës, pasi burrat dominojnë në raport me gratë.

Me gjithë shkollimin dhe aftësimin profesional, gratë në Kosovë vazhdojnë të

mbesin të papërfshira në tregun e punës dhe në procesin e krijimit të bizneseve. Sipas ASK-së, vetëm një pjesë e vogël e grave janë të përfshira në tregun e punës, ndërsa edhe bizneset drejtohen kryesisht nga burrat. Në Kosovë, llogaritet që rreth 78% e bizneseve udhëhiqen nga burrat, ndërsa vetëm 18% janë në pronësi të grave.

Diskriminimi shfaqet edhe në regjistrimin e pronës. Në Kosovë, sipas të dhënave të Agjencisë Kadastrale, janë 608.317 prona të regjistruara - prej tyre 476.394 ose 78.31% janë në emër të burrave dhe 119.728 ose 19.68% në emër të grave.

Përkundër këtyre të dhënave, institucionet vazhdimisht kanë njoftuar për trendë pozitivë të regjistrimit të pronës dhe përfshirjes së grave në biznes.



# vipa



**SHIJE TË PAREZISTUESHME**

*Vipa Chips gjithmonë pranë jush!*





# MUAJI I EPOPESË SË UÇK-së

**M**arsi i vitit 1998 kujtohet si muaji i Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Epopeja e Jasharëve, manifestimi që kujton veprën dhe sakrificën e familjes së komandantit Adem Jashari, është njëra nga ngjarjet kryesore historike.

Në datat 5-6-7 mars 1998, në kullat e Jasharëve u zhvillua beteja, në të cilën mbetën të vrarë pjesa më e madhe e anëtarëve të familjes Jashari.

Të dhënat zyrtare të Qeverisë së Kosovës konfirmojnë se në këto data në Prekaz u vranë 59 anëtarë dhe të afërm të familjes Jashari.

Në kujtim të veprës së familjes Jashari, çdo vit institucionet e Kosovës organizojnë Epopenë e Jasharëve.

Në kuadër të organizimeve zhvillohen aktivitete të shumta, pjesa më e madhe e të cilave zhvillohen në Prekaz. Nata e zjarreve është manifestimi kryesor, i cili zhvillohet mbrëmjen e 7 marsit.

Gjatë vizitës në Prekaz, vizitorët mund të shohin edhe hapësirat e ndërtuara për të kujtuar familjen Jashari.

Varrezat e Dëshmorëve në Prekaz: Ky është një nga vendet më të rëndësishme për nderimin e jetës dhe

sakrificës së familjes Jashari dhe atyre që luftuan për liri. Aty mund të vizitosh varrezat e dëshmorëve dhe memorialin, që ruajnë kujtimin e të gjithë atyre që dhanë jetën për çlirimin e Kosovës.

Shtëpia e Jasharëve dhe Memoriali i Jasharëve:

Në Prekaz mund të vizitosh edhe shtëpinë e familjes Jashari, e cila është shndërruar në muze dhe memorial. Ky vend është një homazh për familjen dhe luftëtarët që dhanë jetën për lirinë e Kosovës. Në këtë muze mund të shohësh fotografi historike, relikte dhe dokumente që i përkasin periudhës së luftës.

**“ KËNDI I DËSHMORËVE NË PREKAZ: Ky vend është një tjetër memorial i rëndësishëm për nderimin e familjes Jashari dhe luftëtarëve të tjerë të UÇK-së. Është një pikë e rëndësishme për vizitorët që duan të njohin historinë e betejave të famshme të zhvilluara në këtë zonë.**



Muzeu i Luftës në Kosovë: Ky muze ndodhet në Prishtinë dhe ofron një pamje të gjerë mbi ngjarjet e luftës, duke përfshirë edhe Epopenë e Jasharëve dhe rolin e tyre në luftën për lirinë e Kosovës.

### **Epopeja e Dukagjinit**

Epopeja e Dukagjinit është manifestimi tjetër që shënohet për të kujtuar luftën e UÇK- së. 24 marsi 1998 shënon betejën e Glllogjanit, njëra nga betejat e para frontale ndërmjet forcave serbe dhe UÇK-së në Dukagjin.



**Çdo vit institucionet e vendit organizojnë manifestimin e Epopesë së Dukagjinit.**

Mijëra njerëz mbledhen në hapësirën e varreve të dëshmorëve



në Glllogjan për të kujtuar betejën dhe heronjtë e rënë.

Historia e betejës dhe betejave të tjera të kësaj zone është grumbulluar në kullat që ndodhen në kompleks, ndërsa vizitorët mund të kalojnë në hapësirat e tjera të komunës së Deçanit, të cilat kujtojnë luftën e viteve 1998-1999.



# TELESKOPI GJIGANT NGA I CILI VËZHGOHEN PLANETËT

Në fshatin Rashincë të Shtimes, entuziastë të astronomisë kanë arritur të ndërtojnë një qendër, e cila është e pajisur me teleskop për të vëzhguar planetët.



**Q**endra e Observatorit dhe Planetariumit Kombëtar të Kosovës, gjatë vitit 2024, u vizitua nga mbi 5 mijë vizitorë, ndërsa kjo qendër njihet për dy teleskopë të fuqishëm, përmes të cilëve nxënësit, studentët dhe entuziastët e fushave STEM mund të vëzhgojnë qiellin dhe trupat qiellorë.

Toka ku shtrihen Observatori dhe Planetariumi Kombëtar i është dhuruar Komunës së Shtimes nga profesori i astronomisë, Milam Rushiti. Rushiti njëherësh është edhe kryetar i organizatës “Astronomy Outreach of Kosovo” (AOK), e cila menaxhon Observatorin dhe Planetariumin Kombëtar të Kosovës.

**“ Njëri nga teleskopët në Observatorin dhe Planetariumin Kombëtar të Kosovës është i vendosur fizikisht në dhomën për vëzhgime qiellore, ku ndodhet kupola që hapet gjatë vëzhgimit të planetëve dhe satelitëve të tyre, si: Venera, Marsi, Jupiteri dhe katër hënat e tij, Saturni dhe unazat e tij, Neptuni dhe Urani.**

Ky teleskop është 14” (356 mm) dhe i është dhuruar si donacion AOK-ut nga kompania e njohur “Celestron”.

Përveç planetëve, përmes teleskopit 14, mund të vëzhgohet Hëna (sateliti natyror i Tokës), ku mund të shihen krateret e saj. Po ashtu, mund të vëzhgohen galaktika si Rruga e Qumështit, Andromeda, si dhe retë e mbushura me pluhur kozmik (Nebula).

Ndër teleskopët e tjerë, veçohet një teleskop solar, përmes të cilit mund të vëzhgohen Dielli dhe njollat e tij të zeza. Në katin përdhës ndodhet Planetariumi me kupolën e tij. Në Planetarium shfaqen video-materiale edukative rreth fushave STEM, në veçanti ato të astronomisë, dhe duket sikur gjithësia (universi) është brenda në Planetarium, për shkak të ndërtimit dhe formës së tij. Në Planetarium shfaqjet të japin ndjesinë e udhëtimit në kohë, një përjetim të vërtetë.

Për të vëzhguar natën me pajisje teleskopike, Observatori dhe Planetariumi janë të hapur për vizitorë gjatë ditëve të javës – të martën, të enjten dhe të shtunën, nga ora 19:00 deri në ora 00:00.

Për grupe njerëzish që duan ta vizitojnë dhe të vëzhgojnë me pajisje teleskopike, kjo është e mundur nga e marta deri të premten. Ndërsa gjatë fundjavës, nga ora 10:00 – 17:00, kryhen vëzhgime të Diellit dhe shfaqje në Planetarium.

Ndërtimi i Observatorit dhe Planetariumit Kombëtar të Kosovës ka kushtuar rreth 310,000 euro dhe është





mbështetur nga Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI) dhe Komuna e Shtimes.

Arsyeja pse është ndërtuar në fshatin Rashincë, përveç dhurimit të tokës nga profesori Rushiti, përkon me plotësimin e faktorëve të domosdoshëm për vëzhgimin e qiellit. Si faktorë kyçë gjatë vëzhgimeve ditore vlen të përmenden: të parët e mirë, kushtet klimatike dhe pajisjet teleskopike. Ndërsa për vëzhgimet gjatë natës vlen të përmenden ndotja e ulët nga ndriçimi artificial, stina dhe topografia relievore (lartësia mbidetare).

Krahas këtyre, Observatori dhe Planetariumi Kombëtar i Kosovës është i pajisur edhe me një dhomë konferencash. Aty ligjërohet për shkencë, si: matematikë, fizikë, kimi, gjeografi, me theks të veçantë në astronomi, astrofizikë, kozmologji dhe fusha të tjera STEM.

Për operimin e pajisjeve teleskopike, ekziston dhoma e operimit, e cila ende është në



proces kompletimi me aparaturë ngasëse automatike, elektronike e digjitale, përmes së cilës tentohet të arrihet përsosmëria e të dhënave të lexuara nga thellësitë e gjithësisë (universit).

Synimi i organizatës "Astronomy Outreach of Kosovo" është realizimi i vëzhgimeve të panjohurave në thellësitë e gjithësisë (universit) edhe përmes pajisjeve radioteleskopike. Aktualisht, veprimtaria është e kufizuar vetëm në brezin optik (gjatësia valore) natyror të të parit të syrit të njeriut.

# LAHUTA E KËNGËVE KRESHNIKE

**K**ëngët e eposit shqiptar përshkruhen me një prej instrumenteve më të veçanta të zonës së Ballkanit. Lahuta është një instrument i veçantë, që përdoret vetëm në këtë rajon, dhe shoqëron kryesisht këngët që këndohen në veriun e Shqipërisë, si dhe në disa zona të Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut. Ajo është e njohur për tingujt e saj të theksuar dhe të thellë, të cilat shoqërojnë recitimin e këngëve epike, siç janë këngët e heronjve.

Produksioni i lahutës kërkon mjeshtëri të veçantë dhe përdor materiale natyrore, si druri, lëkura dhe litarët. Ja një përshkrim i proceseve kryesore të prodhimit të lahutës:

**Përzgjedhja e drurit:** Druri më i përdorur për trupin e lahutës është lisi, i cili është i fortë dhe i qëndrueshëm. Druri duhet të jetë i thatë dhe pa krisje. Pjesa e trupit të lahutës është e formuar në një shklop të ngushtë dhe të gjatë.

**Punimi i trupit:** Trupi i lahutës është shpesh i gdhendur me dorë dhe mund të ketë forma të ndryshme. Pas gdhendjes, trupit i jepet forma e

kërkuar dhe më pas i bëhet një shtresë mbrojtëse për ta ruajtur nga lagështia dhe dëmtimet.

**Përgatitja e dritares:** Lahuta ka një pjesë të quajtur "dritare", e cila është e mbuluar me lëkurë të tendosur. Kjo lëkurë i jep instrumentit një tingull të veçantë. Lëkura përdoret për të mbuluar pjesën e trupit, duke krijuar një hapësirë rezonante.

**Krijimi i gishtave dhe shtizës:** Lahuta ka gishta të formuar nga një material tjetër, shpesh druri i holluar. Shtiza e lahutës është e lidhur me gishta dhe shërben për të mbajtur litarët e tendosur.

**Përgatitja e litarëve:** Litarët e lahutës janë të rëndësishëm për prodhimin e tingullit. Ata janë zakonisht prej najloni ose materiali tjetër të qëndrueshëm dhe të fortë. Litarët tërhiqen për të krijuar tensionin e nevojshëm për të prodhuar tingujt.

**Përfundimi dhe rregullimi:** Pas përfundimit të ndërtimit, lahuta kalon në një fazë të rregullimit të tingujve. Pjesa më e rëndësishme është tensionimi i litarëve dhe balancimi i tingujve që dalin prej saj.



Vitamina • Minerale • Hekur • Proteina

**LIRI**  
Since 1985



# Sempre

Rritemi së bashku me minerale dhe vitamina.

Biskotat Sempre janë të prodhuara nga përbërës të ushqyeshëm, duke i siguruar fëmijës tuaj vitamina dhe minerale thelbësore.

Duke kafshuar dhe përtypur biskotat Sempre, më të vegjlit tuaj stimulojnë mishin e dhëmbëve dhe lehtësojnë daljen e dhëmbëve të parë.



Një porcion (100g) SEMPRE biskota përmban:

Energji	Proteina	Sheqer	Yndyrna	Natrium
343 kcal	9.0 gram	24.13 gram	10 gram	0.3 gram
18%				

Vlera mesatare e rekomanduar për fëmi në bazë ditore për konsumim prej 1800 kcal





# NGA FABRIKAT MODERNE DERI TE PRODHIMI CILËSOR, SI PRODHOHET QUMËSHTI I KOSOVËS

**P**ërpunimi i qumështit në Kosovë është një veprimtari në rritje, e cila arrin të përpunojë rreth 220 mijë litra qumësht. Të dhënat tregojnë se kjo industri arrin të përmbushë 36% të nevojave të vendit.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, në 'Raportin e Gjelbër 2023', prodhimi i përgjithshëm i qumështit në vitin 2022 ishte 276 mijë tonë.

Bazuar në këtë raport, bilanci tregtar mbetet edhe më tutje negativ me 36.7 milionë euro importim të qumështit nga vendet e jashtme.

Konsumi për kokë banori sipas të dhënave nga 'Raporti i Gjelbër 2023', ishte 165 kg në vit që do të thotë se një person konsumon rreth 0.45 kg në ditë, duke përfshirë qumështin dhe produktet e tij.

Në vitin 2022 sipas të dhënave në 'Raportin e Gjelbër 2023', Kosova arriti t' i mbulonte me 81 për qind nevojat për përdorimin e qumështit, kurse pjesa tjetër është mbuluar nga importi.

Rrustem Rukolli, pronar i kompanisë Drena, tregon se kapacitetet përpunuese në kompaninë e tij janë rreth 220 mijë litra në ditë. Kjo sipas tij është e mundur pasi viteve të fundit kanë investuar në rritjen e kapaciteteve përpunuese.

"Falë investimeve në vazhdimësi Drena ka arritur që të ndërtoj kapacitete e saja përpunuese/prodhuese mbi 220,000 litra qumësht në ditë"- tregon ai.

**“Bazuar në të dhënat e Agjencionit Statistikor të Kosovës, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, institucioneve të ndryshme dhe organizatave, dhe hulumtimeve të vet kompanisë rreth tregut, kërkesave direkte që vijnë nga terreni, Kosova ende nuk arrin t' i përmbushë nevojat e brendshme me qumësht.**

"Edhe pse shteti produktin e qumështit e ka të kategorizuar si produkt i një rëndësie strategjike, në fakt ka vend për më shumë përkrahje të fermerëve dhe prodhuesve të qumështit. Me qëllim të përmirësimit të situatës së tanishme, duhet që të krijohen politika me të favorshme për zhvillim të më tutjeshëm të këtij sektori i cili kontribuon në përmirësimin e kushteve të jetesës, sigurinë e ushqimit dhe të ushqyerit dhe njëherit ofron mundësinë e kthimit me shpejtë të investimeve, krijimin e të hyrave tek fermerët dhe prodhuesit"- tregon Rukolli.

Sipas tij, falë kualitetit të produkteve dhe një brendi të besuar, Drena ka kërkesa nga vende të ndryshme të Europës dhe SHBA për eksport të produkteve të saja.

"Për momentin, ne eksportojmë vetëm në dy shtete, Shqipëri dhe Mal të Zi. Barrierë e madhe në eksport për Drena dhe prodhues tjerë vendore, është, mos njohja e 5 vendeve të Bashkimit Europian e shtetit

të Kosovës, duke bërë që produktet e qumështit të limitohen në tregjet e jashtme. E, që të njëjtat masa nuk vlejnë për ata prodhues/tregtarë të jashtëm që synojnë tregun e Kosovës"- tregon Rukolli duke theksuar se presin që në të ardhmen të mos kenë këto barriera sa i përket eksportit.

Të dhënat e ofruara nga Shoqata e Prodhuesve të qumështit tregojnë se brenda një viti mesatarisht sektori i qumështit përkrahet nga Ministria e Bujqësisë me mbi 26 milionë euro.

"Bazuar në të dhënat zyrtare nga Raporti i Gjelbër, buxheti total për mbështetjen për vitin 2022 ishte 26.3 milionë euro, i ndarë për Masën 1 - 13 milionë euro, Masën 3 - 5.8 milionë euro, Masën 7 - 7.2 milionë euro dhe Masën 5 - 200,000 euro. Përafërsisht ka qenë e njëjtë edhe dy vitet tjera"- thuhet në përgjigjet nga Shoqata e Prodhuesve të qumështit.

Nga kjo shoqatë tregojnë se me rritjen e përkrahjes për prodhuesit dhe fermerët mund të rritet edhe prodhimi duke mos përjashtuar edhe rritjen e cilësisë.

"Përkrahje për prodhuesit e qumështit ka me anë të pagesave direkte dhe granteve, pagesa direkte për sipërfaqe, krerë dhe cilësi të qumështit"- thuhet në përgjigjet nga Shoqata e Prodhuesve të qumështit.

Të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë tregojnë se për vitin 2024 mbështetja për fermerët për sektorin e qumështit ka qenë rreth 5.8 milionë euro, kurse 1.5 milionë euro janë në kategorinë për cilësinë e qumështit për fermerët që arrijnë cilësi më të lartë të qumështit.

Sipas të dhënave nga Ministria e Bujqësisë për vitin 2024 subvencionimi për lopë qumështore ishte nga 90 euro për krerë, ndërsa ka rritje të përkrahjes për kafshët e imta nga 25 në 30 euro për krerë, konkretisht për dhitë. Dyfishim i përkrahjes për kafshët e mëdha nga 90 euro në 180 euro për krerë, konkretisht për buallica.

Në anën tjetër, sipas Rukollit, Drena tashmë ka një gamë të madhe të produkteve, duke mbajtur kështu pozitën e liderit në Republikën e Kosovë, me numrin më të madh të produkteve të qumështit dhe me kualitet të produkteve.

"R & Rukolli Group, dhe Drena si pjesë e saj ka ndërtuar dhe shtuar kapacitet prodhuese. Tani jemi në fazën e fundit të testimeve për prodhim edhe të një numri të madh produktesh. Janë mbi 12,000 m2 hapësirë e prodhimit dhe dhjetëra linja prodhuese të teknologjisë më të fundit, që priten se filluari punën në këtë fillimvit. Brendet e reja që presin dritën jeshile për dalje në treg, si sub brende të kompanisë"- thotë Rukolli.

Sipas Rukollit, Drena tashmë ka një gamë të madhe të produkteve, duke mbajtur kështu pozitën



e liderit në Republikën e Kosovë, me numrin më të madh të produkteve të qumështit dhe me kualitet të produkteve.

"Janë mbi 85 produkte me emërtime, peshë, paketim, dizajne dhe specifika të veçanta që prodhohen nga kjo kompani. Shembulli më i mirë është, ku vetëm nga kategoria e jogurtëve, Drena numëron 12 sosh, po ashtu edhe në kategorinë e qumështit UHT (paketim tetrapak) janë 8 lloje të tyre. Thënë shkurt, Drena prodhon të gjitha llojet e qumështit dhe produkteve të tij, duke bërë një diferencim në tregun Kosovar dhe jo vetëm. Ndër të tjera, Drena është prodhuesi i vetëm në Kosovë i Kefirit"- thotë Rukolli.

### **Standardet në prodhim**

Pronari i Drena-s, Rrustem Rukolli tregon se pjesa e prodhimit në fabrikë zbaton standardet më të larta të kontrollit mbi cilësinë e produktit dhe shërbimit dhe se pajisjet e instaluar në fabrikë, janë prej prodhimit më të fundit (më moderne), që vijnë nga vendet e Bashkimit Europian.

"Proceset e punës, janë mirë të dizajnuara duke kompletuar ciklin e operimeve, prej zingjirit të furnizimit, e deri tek produkti final. Kur është fjala tek kushtet dhe cilësia e produkteve të saj, prej grumbullimit të qumështit, prodhimit, ambalazhim të jashtëm, distribuimit, etj., Drena është certifikuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në Kosovë, ISO 9001, HACCP dhe Ushqim Hallall, duke demonstruar përkushtimin e saj për ruajtjen e standardeve më të larta. Po ashtu, stafi ynë është i kualifikuar prej profileve me të ndryshme të ekspertëve, që e bën Drenën një prodhues të kompletuar në të gjitha aspektet"- thotë ai.

Ai tutje tregon se Drena e themeluar në vitin 2015,



sot është fuqizuar si në aspektin e kapitalit dhe në kapacitetet operative me brendet dhe nen-brendet e saja, dhe me markat e kompanisë amë, duke e bërë atë si një model biznesi me të pëlqyer dhe më me perspektivë.

“Drena ndihet e privilegjuar dhe e përmbushur që mund të japë më të mirën për vendin e saj, kur dihet se sektori i qumështit në Kosovë kontribuon afër 10 për qind në BPSH/GDP, duke ofruar punësim të drejtpërdrejtë dhe duke përmirësuar të ardhurat e familjeve, sidomos atyre rurale. Falë një përkushtimi maksimal nga ana jonë dhe gjithë stafit, ky biznes familjar, arriti të rritet dhe zhvillohet çdo vit mesatarisht mbi 35%”- thotë ai.

“Në nëntor të vitit 2017, Komiteti Zgjedhor për International Food & Beverage Quality Award zgjodhi Drenën për çmimin e vitit. Vendimi i tyre u bazua në informatat e marra nga 7,500 ndërmarrës anëtarë të Klubit Global Trade Leaders, nga 90 vende të ndryshme. Ky çmim u krijua nga Klubi Global Trade Leaders, me qëllim që t'i dallojë kompanitë e çdo dege industriale, produktet dhe shërbimet e të cilave kanë merituar njohje dhe lavdërim publik përgjatë vitit. Çmimi në fjalë promovon filozofinë e kualitetit në industrinë e ushqimit dhe të pijes, gjë që u mundëson ndërmarrjeve arritjen e ekselencës në prodhim dhe distribuim”, tregon ai.

Tutje Rukolli kujton se më 5 tetor 2023, në Shkup, Open4 Business Made in the Balkans Supported by the European Union, Drena ishte prezantuar si “Si storie e suksesit” dhe biznesi me rritjen me të shpejtë në 5 vitet e fundit.

“Kjo është treguesi më i mirë, se Drena tanimë është një biznes i qëndrueshëm dhe i tejkalon kufijtë edhe jashtë Kosovës”- thotë ai.

Me punën e tyre, kjo kompani ka arritur që të

punësojë numër të konsiderueshëm të punëtorëve.

“Drena është një punëdhënës dhe tatim pagues i madh, me një impakt të konsiderueshëm në ekonominë e vendit. Sot në kompani janë të punësuar mbi 200 punëtorë direkt, të cilët gëzojnë benefite dhe kushte solide të punës. Derisa, indirekt ky numër është minimum 10-fishi i numrit të rregullt të punëtorëve”.

Sipas Rukollit bashkëpunimi me qindra fermerë nga e gjithë Kosova ka ndikuar që numri i të punësuarve indirekt falë aktiviteteve të kompanisë Drena të jetë shumëfish më i lartë nga ai i të punësuarve direkt në kompani.

“Fermerët dhe familjaret e tyre, punëtorët e tyre të angazhuar në stalla dhe punë tjera, marketet dhe zinxhiri i tyre – stafi tyre, etj., furnitor/prodhues të ndryshëm që janë të përfshirë në proces, mjetet motorike, makina, impiante dhe mirëmbajtja e tyre, etj., krejt kjo e rritet qarkullimin i njohur si efekti multiplikativ ekonomik. Kjo veç është e ditur, se kur blejmë prodhime vendore, me shumë para qëndrojnë brenda kufijve të shtetit, rritet numri i të punësuarve dhe zvogëlohet sasia e importeve”- tregon ai.

### **Bashkëpunimi me bizneset vendore**

Nëpërmjet përkushtimit të punëtorëve të Drenas-s, Rukolli tregon se i shërbejnë komunitetit me produkte origjinale, unike.

“Ky mision, nuk do mund të përmbushej i vetëm nga Drena, po mos të kishte një bashkëpunim të shkëlqyer me partnerë siç janë biznese, Horeca, markete dhe qendra tregtare. Falë këtij bashkëpunimi, ne kemi shtrirje në treg në çdo pjesë të Kosovës. Ne jemi kudo dhe në çdo kohë”- tregon ai.

Ai tutje shton se marrëdhëniet e shkëlqyera me fermerët, përbëjnë një gurthemel të fortë për një kualitet të qëndrueshëm të produkteve të Drenës.

“Përveç mbështetjes së fermerëve në rritjen e kapaciteteve të tyre, Drena siguron edhe treg të sigurt për qumështin e tyre, duke krijuar një kohezion ndërmjet fermerit dhe prodhuesit. Sasia absorbuese - kapacitetet e pikave të grumbullimit të qumështit ndryshojnë sipas sezonit, por mund të thuhet se i gjithë territori i Kosovës është i mbuluar me këto pika prezence. Çdo ditë, 24 orë në ditë, stafi ynë ndodhet në terren duke siguruar grumbullimin e qumështit të freskët dhe cilësor”- thotë ai.

Tutje ai tregon se në Strategjinë e rritjes dhe zhvillimit tek Drena, nuk ekziston rritja e njëanshme. Sipas tij Drena nisat prej parimeve se ‘është mirë kur rriten të gjithë se bashku!’.

“Bashkëpunimin dhe partneritetin tanë, me fermer e kemi në forma të ndryshme.

Një nga to është edhe partneriteti trepalësh: Bankë - Drena – Fermerë, duke u mundësuar atyre të modernizojnë praktikat e tyre bujqësore, të investojnë në pajisje të avancuara dhe të përmirësojnë teknikat e menaxhimit të bagëtive dhe të rrisin kapacitetet e tyre në përgjithësi. Mandej, Drena përmes programit të saj të disbursimit, jua ka lehtësuar/kompensuar kthimin e kredisë – përmes qumështit të deponuar nga fermerët. Kjo është veç një nga modalitetet e ndihmës dhe partneritetit me fermerë”, thotë ai.

Sipas Rukollit, plani për të ardhmen është që të vazhdohet me modalitet të ndryshme dhe teknika të kombinuara, me qëllim që fermerëve të i krijohet kushte me të mira, mundësi të reja për zhvillim, e në të njëjtën kohë Kosova ti përmbush kërkesat e saja me prodhim të qumështit vendor. Ai thotë se për ‘Për Drenën, ky është veç një fillim!’: “Drena është duke u zhvilluar çdo ditë. Drena është prodhues dhe përpunues i një game të madhe të produkteve jo vetëm të qumështit. Ne kemi ndërtuar dhe shtuar kapacitet prodhues dhe jemi në fazën e fundit të testimave për prodhim. Janë mbi 12,000 m2 hapësirë e prodhimit dhe dhjetëra linja prodhuese të teknologjisë më të fundit, që priten së filluari punën në këtë fillim vit”- tregon Rukolli, duke shtuar se brendet e reja që presin dritën jeshile për dalje në treg, si sub-brendet të Drena-s, janë prej më të ndryshmeve, si pije freskuese, pije të gazuara, pije natyrale (smoothie), pije në paketim tetrapak, të gjitha llojet e çajit të ftohtë, pije energjike, etj.

“Ne kishim një Mision dhe Vizion të qartë, ndonëse të përcjellur më shumë sfida. Por, Drena këto sfida i ktheu në mundësi të reja për zhvillim. Misioni i Drenës ishte dhe mbetet që të frymëzojë një shoqëri të shëndoshë, duke i lidhur njerëzit me ushqim të vërtetë dhe natyral. Ndërsa rritemi së bashku, ta rrisim edhe kënaqësinë e blerësve, duke ofruar prodhimet më të freskëta në mënyrën më miqësore, me nder dhe me komunikim

të sinqertë”- thotë Rukolli, teksa kujton rrugëtimin e Drena-s.

Ai thekson se pa një bazë të shëndoshë nuk mund të arrihet tek produktet e shëndosha dhe për këtë ai shton se me kujdes dhe përkushtim, Kompania Drena ka arritur që të shtrijë prezencën e tyre pothuajse në çdo tryezë familjare.

“Ne besojmë që kujdesi për kafshët dhe mirëqenia e tyre, është thelbësore për prodhimin e një qumështi me kualitet të lartë. Kjo veç është e vërtetuar gjatë një dekade, për aq sa Drena ka që operon në treg. Qumështi në Drena vjen drejtpërsëdrejti nga kafshët e ushqyera në natyrë. Kjo ka impakt direkt në kualitet të produktit dhe në shëndetin e njeriut”- tregon ai.

### **Përkrahja e sportistëve dhe komunitetit**

Sporti, arti, kultura janë ambasadorët më të mirë të një vendi. Duke ditur mirë vlerat që përfaqëson Drena për komunitetin ku zhvillohet biznesi, Rukolli thotë se kanë mbështetur të rinj dhe të reja, sportistë, artistë, klube të ndryshme në aktivitetet e tyre.

“Një nga storiet e suksesit në sport, ku Drena ka përkrahur që nga ditët e para, është Xhudo, me saktësisht klubi ‘Ippon Peja’ me mjeshtrin e madh Toni Kuka. Nga ky klub, që i ka lakmi e gjithë bota, kanë dalur shumë talentë, kampionë, duke e vendosur shtetin e Kosovës në hartën e triumfuesve të dhjetëra medaljeve olimpike dhe titujve – kampion. Mjafton të përmenden emrat si: Majlinda, Distria, Nora, Akili, Erza, Dardani, Laura, Sidorela, Loriana, etj., dhe emri Kosovë lartësohet në çdo garë”- thotë Rukolli.

Tutje ai shtoi se me krenari dhe mburrje, mbahet llogoja Drena në veshjet e sportistëve elitari

“Ky është sukseksi i yni i përbashkët! Kjo është Drena!”- përfundoi Rukolli në rrëfimin e tij për kompanie Drena, një emër i njohur tashmë dhe i dëshmuar për produktet e saj cilësore.



# ÇFARË DIMË PËR DJATHIN PARMEGIANO?

Njëri nga djathërat më të veçantë në botë është djathi Parmegiano. I prodhuar në një zonë të mbrojtur gjeografike, ky djathë është unik për shijen dhe cilësinë e tij të jashtëzakonshme.

## Origjina dhe zona gjeografike

Parmegiano prodhohet vetëm në një zonë specifike të Italisë, që përfshin qytetet dhe rajonet: Parma, Reggio Emilia, Modena, si dhe disa pjesë të Bolonjës dhe Mantovës. Kushtet unike, klimatike dhe gjeografike, të këtyre zonave ndikojnë në cilësinë dhe shijen e këtij djathi.

## Historia

Historia e djathit Parmegiano fillon që në shekullin e 12-të. Receta e prodhimit është ruajtur brez pas brez nga banorët e këtyre zonave, duke mbetur e pandryshuar ndër shekuj.

## Përbërësit dhe procesi i prodhimit

Djathi përgatitet vetëm me:

- Qumësht të freskët lope,
- Kripë,
- Nëntharm natyral.

Ai nuk përmban asnjë lloj aditivi apo konservanti.

Procesi i prodhimit përfshin një periudhë të gjatë të vjetërsimit, e cila zakonisht zgjat nga 12 deri në 36 muaj. Gjatë kësaj kohe, shija dhe struktura e djathit zhvillohen duke krijuar karakteristikat unike të tij.

## Çfarë është ushqyese

Parmegiano ka një shije të pasur, të cilën e bën pak të kripur, ndërsa aroma e tij ka një nuanca të qumështit dhe të drithë. Ky djathë është gjithashtu i pasur në burim i shkëlqyer i proteinave, kalciumit dhe fosforit. Për shkak të procesit të gjatë të pjekjes, laktoza digradohet, duke e bërë atë të përshtatshëm edhe për ata që vuajnë nga intoleranca ndaj laktozës. Parmegiano nuk është thjesht një djathë i zakonshëm, por një traditë e pasur kulinare dhe mbrojtur që njihet si njëri nga mbrojturit më të mirë të cilësisë italiane që njihet dhe çmohet në mbarë botën.





# FAST LIFE FOREVER TOUR 2026



**GET  
YOUR  
TICKET**

- STUTTGART --- 09.01.2026**
- MÜNCHEN ----- 10.01.2026**
- FRANKFURT ---- 11.01.2026**
- ZÜRICH ----- 13.01.2026**
- BERLIN ----- 15.01.2026**
- HAMBURG ----- 16.01.2026**
- KÖLN ----- 17.01.2026**

# MBI 5800 PERSONA E VIZITUAN “REPORTING HOUSE” NË SHTATË MUAJT E FUNDIT

**Reporting House/Shtëpia e Gazetarëve, muzeu kundër harresës që mblodhi mijëra njerëz në Prishtinë.**

**E**skpozita Reporting House (“Shtëpia e Gazetarëve”) po përgatiet për aktivitete që lidhen me pavarësinë e Kosovës dhe kujtimin e ngjarjeve të marsit që e kujtojnë rezistencën e civilëve kosovar.

Kjo ekzpozitë po shëndrrohet në muzeun më të vizituar që nga shpallja e pavarësisë pasi që mijëra vizitorë kanë ardhur për të mësuar për historinë moderne të Kosovës.

E hapur më 10 qershor 2024, për nder të 25 vjetorit të përfundimit të bombardimeve të NATO-së vetëm në shtatë muajt e fundit deri në fund të janarit 2025, “Reporting House” u shndërrua në destinacion për mbi 5,800 vizitorë nga vende të ndryshme të botës.

Ekspozita mblodhi të gjithë të interesuarit për historinë moderne të Kosovës të shënuar me rezistencën për liri dhe dokumenton periudhën 1989 – 1999, përmes punës së gazetarëve, kameramanëve dhe fotoreporterëve vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe veprave të artit bashkëkohor.

William Walker, ish ambasador amerikan që e vizitoi këtë muze me 23 janar 2025 tha:

“Mënyra se si është aranzhuar kjo ekzpozitë, se si të fut në historinë e Kosovës prej kohës së grevës së minatorëve, protestave me bukë të grave e shumë ngjarje të tjera unik, e më bëri bëri të kuptojë plot gjëra të reja për historinë e Kosovës të cilat nuk i kisha ditur më parë edhe pse unë jam njeri që mirrem me Kosovë që një kohë të gjatë” tha Walker gjatë vizitës 2 orëshe në ekzpozitë.

Interesim jashtëzakonisht të madh kanë shprehur edhe shkollat publike, kolegjet private, universitetet. Gjashtëmbëdhjetë shkolla prej tyre vizituan “Reporting House” vetëm në katër muajt e fundit.

Festa e 28 Nëntorit, shënimit të përvjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, ishte dita rekord për nga numri



i vizitorëve, ku vetëm brenda një dite 231 persona kaluan festën në hapësirën e muzeut.

E vendosur në katin e parë të ish-objektit “Gërmia”, shtëpisë së parë të mallrave në Kosovë, e ndërtuar në vitin 1973, “Reporting House” u shndërrua në një hapësirë jo vetëm dokumentimi, por edhe diskutimi e hulumtimi për gazetarë, hulumtues, e studentë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Personalitete të ndryshme publike shqiptare dhe ndërkombëtare, vizituan “Reporting House”. Disa prej tyre, më tepër se njëherë duke sjellë me vete familjarë, miq e të gjithë të interesuar për historinë moderne të Kosovës.

Më poshtë sjellim përshtypjet e disa prej vizitorëve të cilët dokumentuan përjetime të tyre nga ekspozita në librin e përshtypjeve të “Reporting House”.

Përshtypjet e vizitorëve

“Komplet forma qysh është organizu ky muze, ose qysh me quajtë, është diçka e jashtëzakonshme dhe mendoj se shumë, shumë është me rëndësi me ardhë këtu, sidomos fëmijët me i sjellë me e vizitu këtë vend sepse është vetë historia e dokumentune, jo e shpikun por e dokumentume përmes fotografive dhe videove” – thotë Ferid Berisha, ish-pjesëtar i UÇK-së, i njohur si “Komandant Shkupi”.

Kjo ekzpozitë mund të shihet si një studim më i thellë jo vetëm i luftës dhe pasojave të saj, por edhe i kushteve dhe rrethanave që çuan në të si dhe turbulencave të pasluftës në Kosovë duke i kontekstualizuar ngjarjet jo vetëm brenda Kosovës por edhe në rajon” – thotë Penesta Dika, kuratore dhe hulumtuese.

“Një kujtim i hidhur por i domosdoshëm i historisë moderne të Kosovës” – shkruan Lavdim Klaiqi më 12 dhjetor të këtij viti.

“Ky Muze i rezistencës historike, pavarësisht periudhave që po shfaqen, të gjitha paraqitjet që pata rast t’i shoh, paraqesin tërë rezistencën kombëtare deri



tek akti i shpalljes së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran” – shkroi Ali Ahmeti më 17 dhjetor gjatë vizitës së tij.

“Vetëm e vërteta pajton popujt” – shkruan Shpend Gjuga.

Sa shumë kemi nevojë për publikimin e dëshmive të tilla” – shkruajnë Venera dhe Diana Gjuga.

“Historia që harrohet, përsëritet. Dikur në Kosovë, kurrë më! Bardha Kelmendi dhe Lis Sllamniku ishin këtu”.

“Nëse keni dashur që t’i jepni zë historisë suaj, ju keni arritur këtë [përmes Reporting House, Alessia dhe Sara.

“Ju përgëzojmë për iniciativën e formimit të këtij Muzeu. Uroj që të kemi mundësi të vizitojmë muzeun e dokumentimit të luftës edhe me gjeneratat e tjera” – grupi i mësimdhënësve dhe nxënësve të shkollës fillore “Kadri Kusari” në Gjakovë.

Kjo ekspozitë duhet të qëndrojë e hapur përgjithmonë! Sakrifica dhe vetëflijimi për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës. Me përkushtim të madh duhet të ruhet këtu në Reporting House. Ju përgëzoj për faktet e mbledhura të luftës së fundit në Kosovë” – shkruan Gurakuq Ukaj nga Tetova.

“Përjetime të rëndësishme po shpalosen, e gjithë bota duhet t’i shohë. Faleminderit për ekspozitën!” – ka shkruar Arderisa Rugova nga Gjermania.

“Kurrë nuk harrohen krimet e Serbisë ndaj Popullit të Kosovës. Lavdi dëshmorëve të kombit!” – ka shkruar Esat Mulliqi. “Një përmbledhje historike, prekëse dhe e jashtëzakonshme e të filmimeve që nuk janë parë më parë. Është një paraqitje jetike e informacioneve, që shpresoj se do të ruhen e arkivohen përjetësisht. Profesionalizmi i kësaj ekspozite është përtej gjithçka. Nuk kam parë diçka të tillë më parë dhe Jeta e Gazmendi duhet të urohen. Faleminderit!” – ka shkruar Marc Perry nga Britania e Madhe.

Kënaqësi e nostalgji, rihapja e Germisë. Kujtime të pafund fëmijërie...” – pa emër.

“Na ishte njëherë, që kurrë të mos përsëritet më. Derisa të gjenden të zhdukurit plaga mbetet e hapur...” – pa emër.

“Urime Prishtinë, dhe përshëndetje nga Brazili” – ka shkruar Eges nga Brazili.

“Mua më ka pëlqyer se mësova për historinë e Kosovës edhe fola me komandantin e NATO’s” – Leka.

Nga ekrani i parë e deri në atë të fundit, nr.15 e gjeta veten dhe familjen time afër 60 minutave sa qëndrova duke vizituar ekspozitën. Por mund të them lirshëm se do të vijë edhe disa herë të tjera. Derisa të shoh të gjitha videot e ekspozuara. Do t’i sjellë edhe fëmijët e mi që ta shohin tmerrin dhe përjetimet e paraardhësve të tyre, derisa u çliruar 25 vite më parë. Si person i lindur në 1983, vizita në këtë muze nuk ishte thjeshtë vizitë por rikthim në kohë dhe tmerrin. Ju lumtë organizatorëve për këtë ndërmarje!” – ka shkruar Liridon Shala.

“Një falënderim të thellë për të gjithë gazetarët, fotoreporterët, kameramanët, dhe të gjithë ata që mundësuan që vuajtjet e popullit shqiptar të publikohen në të gjitha mediat ndërkombëtare. I falënderoj të gjithë ata që mundësuan këtë ekspozitë për dokumentimin e fakteve përmes kameramanëve” – ka shkruar Mefail Bajqinovci.

“Ekspozita e bazuar në të vërtetat dhe historinë e popullit tim. Ju lumtë për punën e bërë” – ka shkruar Edi.

“Ishte kënaqësi e veçantë për mua dhe ekipin e Policisë së Kosovës vizita në Reporting House, muzeut të luftës që u organizua nga gazetarja Jeta Xharra dhe ekipi i saj” – ka shkruar Gazmend Hoxha, drejtor i përgjithshëm i Policisë së Kosovës

“Gjatë vizitës së kësaj ekspozite, mbi të gjitha dua të përgëzoj organizatorët e saj. Mendoj se është shumë e qëlluar dhe mbi të gjitha videot dhe fotot janë dëshmi e qartë e vuajtjeve të popullit të Kosovës. Këto materiale dëshmi do të ishte mirë që institucionet tona shtetërore të arkivojnë dhe ti shfrytëzojnë si dëshmi në padi kundër shtetit të Serbisë për gjenocid që ka bërë ndaj popullit shqiptarë” – ka shkruar Isak Shabani, deputet i Kuvendit të Kosovës dhe i mbijetuar i masakrës së Dubravës.

“Ne të gjithë e kemi jetuar luftën, por nuk e kemi parë të plotë atë. Kemi qenë duke luftuar për jetën. Ende kemi shumë për të parë dhe sot pamë çka duhet të njohim mirë e në detaje: krimin gjenocidal të ndodhur në zemër të Evropës” – ka shkruar Tinka Kurti.

“I mahnitur dhe tejet falënderues që keni sjellë këtë frymë artistike, të pa parë në vendin tonë! Jam thellësisht mirënjohës për këtë punë!” – Memli Krasniqi, dirigjent.

“Ekspozita Reporting House shpalos historinë e Kosovës më periudha të ndryshme dhe shumë të rënda dhe të vështira për popullin shqiptar. Sot pata rastin që t’i rikthehem sërish këtyre periudhave. Emocion i veçantë, sa aq edhe krenari, të shoh punën e madhe që është

bërë përmes kësaj ekspozite. Dëshmitë mbi të kaluarën janë ato që na mbajnë të gjallë kujtesën tonë kolektive dhe ngjarjet e rezistencës për popullin tonë!” – ka shkruar Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë.

“Ne kemi nevojë për lokacione. Më lejoni të them këtë, babai im vdiq në 1992 dhe unë vetëm në vitin 2004 arrita të gjej trupin e tij, në 2005 e varrosëm. Dhe vitet prej 1992 deri 2005 kanë qenë të tmerrshme, Brenda meje kishte një humnerë të zezë. Njerëzit kanë nevojë për lokacione. Kanë nevojë për varreza, për vende të tilla [muze], sepse janë të nevojshme për neve, që të shkojmë. Unë kisha një takim me kryeparlamentarin tuaj dhe i thash, ju duhet të centralizoni memorien kolektive, narrativën, historinë. Ju duhet të tregoni historinë e plotë, në formë koherente dhe me kuptim, në atë formë që të ruani identitetin tuaj. Ne jemi kush jemi, për shkak të atyre që kemi kaluar” – ka shkruar Emir Suljagic, i mbijetuari i gjenocidit të Srebrenicës dhe drejtori i Qendrës Përkujtimore të Srebrenicës/Bosnjë e Hercegovinë.

### Një hap kundër harresës

Muzeu “Reporting House” (“Shtëpia e Gazetarëve”) është projekt i realizuar nga BIRN në Kosovë dhe Kallxo.com, me producente Jeta Xharrën, “Paper Gallery” dhe “Prishtina Biennale”, me kurator profesorin e artit, Gazmend Ejupi. Gjithsej muzeu dokumenton mbi 30 orë video materiale, fotografi dhe vepra të artit nga 8 artistë të ndryshëm, shqiptarë dhe ndërkombëtarë.

Jeta Xharra, gazetare por edhe realizatore e këtij muzeu (ajo kishte punuar gjatë luftës për BBC-në) e ka marrë iniciativën për t’i digjitalizuar 30 orë materiale të mediave të huaja që kanë raportuar për Kosovën, si iniciativë kundër harresës. Kanë kaluar 25 vjet pas lufte dhe ka ardhur koha që të luftojmë, përveç kundër korrupsionit e padrejtësive, ta luftojmë harresën për atë që ka ndodhur në vendin tonë. E kemi hapur këtë muze modern i cili në formë shumë bashkëkohore, pa patetizëm, e shënon kontributin e popullatës civile për lirinë që Kosova e gëzon sot” – ka thënë Jeta Xharra. Duke shënuar një çerek shekulli nga përfundimi i luftës në Kosovë, “Reporting House” i ofron publikut një pasqyrim të hollësishëm të luftës tonë europiane që përmbylli shekullin e 20-të. Ekspozita u mundëson vizitorëve të udhëtojnë në konfliktin që po vlonte gjatë viteve 1990, nga i cili lindi lëvizja guerile e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që më vonë shpërtheu në luftë në vitet 1998-1999 dhe kulmoi me 11 javë të sulmeve ajrore të NATO-s që çuan në çlirimin e Kosovës dhe në pavarësinë e saj në vitin 2008. Ekspozita shpalos draftin e parë të kësaj historie të shkruar nga gazetarët dhe demonstroi rolin qendror që e ka luajtur media krahas interpretimeve artistike të mëvonshme të kësaj historie. Publiku ftohet që ta kuptojë

më tej historinë e jashtëzakonshme të Kosovës, ndërsa ekspozita është e hapur për bashkëpunim për zhvillimin e saj të mëtejshëm.

“Reporting House/Shtëpia e Gazetarëve” ndër të tjera prezantoi vepra të artistëve që vijnë prej vendeve të ndryshme dhe emra të njohur nga bota e artit si Anri Sala nga Shqipëria, Adrian Paci nga Shqipëria, Goncalo Mabunda nga Mozambiku, Lala Meredith Vula nga Anglia, Zhana Kadyrova nga Ukraina, Lana Cmajcanin nga Bosnjë dhe Hercegovina, Olafur Eliasson nga Islanda-Danimarka, Laura Imami nga Anglia dhe Besa Llugiqi e deri te artistët e rinj si Vullnet Jakupi dhe Vita Kasapolli nga Kosova. Gazmend Ejupi, kurator i kësaj ekspozite dhe profesor i artit në Kolegjin UBT, është ideatori i kombinimit të artit modern me gazetari, gjë që e bën kaq unike këtë ekspozitë. “Kemi kombinuar materialet e gazetarëve, fotografitë e videot e tyre me punime të artit bashkëkohor që merret me temën e përvojës së refugjatëve dhe luftës në vendet tjera të botës – thjesht përvojën tonë lokale të rezistencës e kemi bërë përjetim më reflektive në këtë ekspozitë duke i kuruar punimet e artistëve shumë të njohur ndërkombëtar të ekspozohen në qendër të Prishtinës me një hapësirë komplet të re kulturore” – tha Ejupi. Si pjesë e kësaj ekspozite prezantohen rreth 150 reportazhe televizive të rrjeteve televizive botërore që janë transmetuar, me xhirime ekskluzive për Kosovën ndërmjet viteve 1992 dhe 1999, nga BBC, Das Erste (TV publik gjerman), Nippon TV, NHK (TV publik japonez), RTE (TV publik irlandez), EO 2 Vandaag (TV publik holandez), Tele 5 (TV Spanjoll) dhe Frontline Television Neës. Këto reportazhe promovojnë punën e gazetarëve, fotografëve, operatorëve të kamerave dhe përkthyesve e producentëve lokalë që punuan në to.

Kontribuesit në këtë ekspozitë janë Jeremy Boëen, Ben Broëen, Ilaz Bylykbashi, Thomas Dvorzak, Alan Chin, Donika Shahini, Paul Loëe, Max Stahl, Ridvan Slivova, David Loyn, Jehona Lushaku, Besnik Mehmeti, Nik Millard, Andreë Testa, Pal S. Refsdal, Flaka Surroi, Hazir Reka, Marija Ristiq, Fred Scott, Eliza Hoxha, Vaughan Smith, Nora Eëller, Sean Ehelan, Goran Tomasevic, Sami Mustafa, Alban Bujari, Linda Gusia, Eki Rrahmani, Gazmend Avdiu, Srebrenica Memorial Center, Anibar, Koha Ditore, RTK dhe Oral History Kosovo.

Pjesa më e madhe e materialit televiziv arkivor dhe artefakteve janë dhuruar nga Vaughan Smith nga Frontline Neës Television, që punoi në Kosovë në vitet 1998-1999. Kontributin kryesor për transformimin e hapësirës në këtë ndërtesë e ka Komuna e Prishtinës, e cila ka investuar në infrastrukturën e muzeut ndërsa donatori kryesor i kësaj ekspozite është Ambasada Holandeze.

**ROCK  
YOUR  
SPACE**



**S O L O S**

[www.solos.studio](http://www.solos.studio)  
f i solos.studio

**FURNITURE  
LIGHTING  
& MORE**



 **KERASAN**



**The beauty  
remains eternal**

[www.kerasan.net](http://www.kerasan.net)  
f i kerasankosova



## 17 VJETORI ME KONCERT FESTIV NGA FILHARMONIA E KOSOVËS

Për nder të 17 vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, Filharmonia e Kosovës në drejtimin e dirigjentit Baki Jashari do të mbajë një koncert festiv. Koncerti pritet të mbahet më datë 17 shkurt 2025 me fillim nga ora 20:00, në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë në Prishtinë dhe do të transmetohet direkt në Radio Televizionin e Kosovës.

Në këtë koncert festiv janë në program vepra të njohura të kompozitorëve shqiptarë të cilat do të interpretohen nga Kori dhe Orkestra e Filharmonisë.

Sipas programit koncerti do të nis me intonimin Himnit të Kosovës dhe tutje do të interpretohet "Suitë ilire" nga kompozitori Mark Kaçinari me orkestrim të Kirit Lekajt në interpretim të orkestrës.

Këtë vit (2025) shënohet edhe 90-vjetori i lindjes së kompozitorit Kaçinari.

Tutje do të interpretohen 3 vepra premierë të kompozitorëve nga Kosova, "Fantazi për piano" nga kompozitori Blond Krasniqi me solist pianistin e mirënjohur nga Maqedonia e Veriut Shkëlzen Baftijari, poema simfonike



"MIZER-REÇAK" nga Liburn Jupolli dhe kantata për mexosoprano, kor dhe orkestër "I miri i motrës" nga Korab Shaqiri me soliste mexosopranon Flaka Goranci.

Koncerti do të përmbyllet me "Vendi im" për kor dhe orkestër nga Valton Beqiri e shkruar mbi motivet e këngës "Mallëgjimi".

Kosova e shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008-të pas disa vitesh administrimi nga misioni i Kombeve të Bashkuara - UNMIK. Në vitin 2010-të, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë konstatoi se shpallja e pavarësisë nga përfaqësuesit e zgjedhur të popullit të Kosovës nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

# PRISHTINA

RENT A CAR

## Shijo Pushimet Tuaja

Me veturat e modeleve të fundit!



PRISHTINA



Skeno > Shkarko > Rezervo > Zbritje përfito



+38344240383



rentacar-prishtina.com



# ÇKA IMPORTON E ÇKA EKSPORTON KOSOVA?

**Deficiti i lartë tregtar është një prej sfidave kryesore të ekonomisë së vendit. Çdo vit, Kosova eksporton më shumë se 5 miliardë euro jashtë vendit, pasi aq është dallimi ndërmjet importit dhe eksportit të produkteve.**

Në vitin 2023, Kosova kishte importuar mallra në vlerë prej 5.9 miliardë euro, ndërsa kishte eksportuar mallra në vlerë prej 863 milionë euro. Pra, në vitin 2023, mbi 5 miliardë euro kanë dalë më shumë nga Kosova, krahasuar me ato që kanë hyrë në Kosovë përmes eksporteve. Nëse e marrim si përqindje, i bie që eksportet mbulojnë vetëm 14.6% të importeve, që është vlera më e ulët krahasuar me vendet e rajonit.

Deficiti i lartë tregtar përmendet nëpër raportet e institucioneve ndërkombëtare si një sfidë që duhet të adresohet nga Qeveria e Kosovës. Fondi Monetar Ndërkombëtar, në raportin e publikuar në dhjetor të vitit 2024, thotë se deficiti i lartë tregtar është duke i shkaktuar

telashe ekonomisë së Kosovës dhe pasojat e këtij deficiti të lartë tregtar janë duke u sanuar pjesërisht nga remitancat, pra dërgesat nga jashtë dhe investimet e huaja direkte.

Edhe Banka Qendrore e Kosovës, në raportet e saj, e njeh deficitin e lartë tregtar si një prej sfidave kryesore të ekonomisë së vendit.

## **Por, çka importon Kosova?**

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Dogana e Kosovës për vitin 2024, rezulton se Kosova ka importuar naftë në vlerë prej 587 milionë euro gjatë vitit 2024. Kosova nuk prodhon naftë, prandaj importi i naftës nuk mund të zvogëlohet e



as të zëvendësohet me prodhim vendor. Ndërsa, 566 milionë euro ishte vlera e importeve të veturave dhe mjeteve të tjera motorike.

Energjia elektrike është produkti i tretë më i importuar gjatë vitit 2024, duke arritur vlerën e 142 milionë eurove. Kosova importon energji elektrike për të mbuluar deficitin e energjisë që shfaqet kryesisht gjatë ditës, pasi konsumi i energjisë është dukshëm më i lartë sesa prodhimi i saj. Kosova eksporton një sasi të konsiderueshme të energjisë elektrike, mirëpo vlera e saj është dukshëm më e ulët, pasi e njëjta eksportohet gjatë natës, kur çmimi për megavat është shumë herë më i lirë. Bazuar në të dhënat preliminare, që janë raportuar në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, rezulton se gjatë vitit 2024 është eksportuar energji elektrike në vlerë prej rreth 60 milionë euro.

**“ Në listën e produkteve më të importuara pasojnë cigaret, po ashtu një produkt që nuk ka sasi të madhe të prodhimit në Kosovë. Në Kosovë është një fabrikë për prodhim të cigareve, por e cila lëndën e parë (duhanin) e importon, sepse aktualisht nuk ka kultivim në masë të duhanit në Kosovë.**

Medikamentet janë produkti tjetër i importuar në masë të



madhe gjatë vitit 2024, duke arritur vlerën e importit në 120 milionë euro. Në Kosovë janë disa fabrika të prodhimit të ilaçeve, të cilat kanë ndikuar që ky import mos të jetë kaq i madh.

Me gjithë ekzistimin e disa fabrikave për prodhim të pijeve të gazuara, Kosova ka importuar pije

të gazuara nga jashtë në vlerë prej 97 milionë euro. Kosova prodhon edhe biskota dhe produkte të tjera të bukës, mirëpo prapë vlera e importeve të tyre

ishte 85 milionë euro. Në Han të Elezit është një fabrikë për prodhim të çimentos, mirëpo, bazuar në të dhënat e Doganës së Kosovës,

rezulton se Kosova nuk i përmbush nevojat e veta me prodhim të këtij produkti, pasi vlera e importit të çimentos portland ishte 84 milionë euro.

## Prej nga importojmë mallra?

Importi i mallrave për periudhën janar-nëntor 2024, sipas të dhënave Open\_DATA nga Doganat e Kosovës, arrin vlerën 5.7 miliardë euro, që është një rritje prej 8.6% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Kosova më së shumti mallra importon nga vendet e BE-së, me 2.5 miliardë euro apo 44.8% e gjithë importit (Gjermania me 14.1%, Italia me 5.2%, Greqia me 5.1%, Polonia me 3.3%, Bullgaria e Kroacia me nga 2.1%, etj., si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm).

Kurse nga vendet e CEFTA janë importuar mallra në vlerë prej 748.8 milionë euro apo 13.2% (Shqipëria me 5.3%, Maqedonia e Veriut me 4.5%, Serbia me 1.9%, etj., si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm). Ndërsa, nëse ndalemi me shtete individuale, atëherë importi nga Turqia është më i larti, pasi ka arritur vlerën e 828.7 milionë euro apo 14.5%, e pasuar nga Kina me 688.4 milionë euro apo 12.1%.

## Çka eksporton Kosova?

Eksporti i mallrave për periudhën janar-nëntor 2024 arrin vlerën 832.2 milionë euro, që është një rritje prej 5.8% krahasuar me 786.8 milionë euro, periudhën e njëjtë të vitit 2023. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit e përbëjnë: 24.5% metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 11.8% plastikë, gomë



**“ Pas energjisë, Kosova eksporton dyshekë. Vetëm brenda një viti, vlera e dyshekëve të eksportuar gjatë vitit 2024 ishte 99 milionë euro. Kosova ka eksportuar plastikë në vlerë 512 milionë euro dhe pije freskuese në vlerë 47 milionë euro. Sektori i drurit është jashtëzakonisht i zhvilluar në Kosovë dhe kjo dëshmohet edhe nga niveli i eksportit të mobileve që ka arritur në 43 milionë euro. Kurse vlera e strukturave të hekurit dhe çelikut dhe tubat e hekurit, që janë eksportuar, ka arritur në 64 milionë euro.**

dhe artikuj prej tyre; 11.2% artikuj të ndryshëm të prodhuar; 11.2% ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 9.3% produktet minerale

etj., si pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm.

Ndërsa, nëse i marrim në mënyrë specifike produktet që



i eksportojmë, atëherë në listë prin energjia elektrike. Sasia e energjisë elektrike që është eksportuar ka një vlerë prej rreth 60 milionë eurosh. Përveç kësaj, është edhe një pjesë e energjisë elektrike që është eksportuar, mirëpo e njëjta nuk është shitur, por është shkëmbyer me Shqipërinë. Ky shkëmbim është pjesë e marrëveshjes së KEK-ut dhe KESH-it, që këto ndërmarrje e këmbëjnë energji me energji, në varësi të nevojave të dy shteteve. Kryesisht KEK-u i dhuron energji Shqipërisë gjatë verës, kur është piku i sezonit turistik, ndërsa e merr gjatë dimrit, kur Shqipëria ka më shumë energji që prodhohet nga hidrocentralet në kohë të shirave.

**“ Shqipëria është vendi në të cilin Kosova eksporton më së shumti, pasi vlera e eksporteve në këtë shtet gjatë vitit 2024 ishte 247 milionë euro. Më pas vjen Maqedonia e Veriut, me 145 milionë euro, ShBA-ja me 103 milionë euro, Gjermania me 93 milionë euro, Zvicra me 81 milionë euro.**



Për shëndet të mirë!

## Shërbimet:

- Laboratori i biokimisë dhe hematologjisë
- Laboratori i mikrobiologjisë
- Mjekësi familjare
- Pediatri
- Nefrologji
- Psikologji
- Kardiologji
- Endokrinologji
- Pulmologji
- Ortopedi
- Urologji
- Radiologji (përfshirë CT, radiografi)
- Kirurgji e përgjithshme

Prishtinë  
Prizren  
Suharekë  
Gjilan  
Mitrovicë  
Ferizaj

Qendra Tregtare Dardha	+383 48 32 31 30
Rr. Wesley Clark,	+383 48 52 00 08
Rr. Skënderbeu	+383 48 52 00 04
Rr. 7 shtatori	+383 49 52 01 25
Rr. Minatorët e Trepçës	+383 48 52 00 05
Rr. Uran Tinova	+383 48 52 05 25

**Olive Clinic** kujdeset për shëndetin tuaj!

**ART**  
MOTION

315+  
KANALE TV

40+ LIGA  
SPORT HD

INTERNET DERI  
500 Mbps

TË GJITHA  
KANALET  
DIGITALB

tring

BIG BROTHER  
VIP KOSOVA

BIG BROTHER  
VIP

*Tjetër nive*

Çdo ligë,  
çdo emocion.



www.artmotion.net 0800 20 500



GROUP  
**Blendi**

shpejt,  
lirë dhe  
kualitet

SHTYPSHKRONJË | REKLAMA & 3D | MATERIAL ZYRTAR  
MATERIAL SHKOLLOR | RAFTA METALIK | KARRIGE PËR ZYRE

www.blendi-ks.com

blendigroup



KATALOGU  
MAKINERIVE



KATALOGU  
PROMOCIONAL

*Scan Me!*

# PRODHIMI I VESHJEVE NGA KREATORËT E KOSOVËS

Tekstili dhe prodhimi i veshjeve është njëri nga sektorët e rëndësishëm të industrisë në Kosovë. Kjo industri punëson qindra punëtorë dhe luan një rol të madh në zhvillimin ekonomik të vendit.

**A**i është bërë një sektor i rëndësishëm për punësimin e fuqisë punëtore, duke ofruar mundësi për zhvillim profesional dhe ngritje të aftësive. Pavarësisht sfidave që mund të ketë, siç janë konkurrenca e jashtme dhe kërkesat e tregut të ndryshueshëm, sektori ka vazhduar të tregojë fleksibilitet dhe përshtatshmëri. Kosova ka një numër fabrikash dhe kompanish që janë aktive në sektorin e prodhimit të veshjeve.



**K**ëto ndërmarrje janë kryesisht në Prishtinë, Prizren, Ferizaj dhe Gjakovë. Disa nga fabrikat më të mëdha të tekstitit në vend janë: “Jatex” dhe “Intertex Kosova” në Gjakovë, si dhe fabrika e parë e xhinseve “Kosovatex” në Prishtinë. Përveç kësaj, ka disenjatorë dhe marka të ndryshme që furnizohen nga vende të ndryshme të Evropës dhe disa nga ta i krijojnë vetë materialet e tyre. Një shembull i tillë është kreatorja **Krenare Rugova**, e cila ka krijuar “KR LAB”. Laboratori i është dedikuar teknikës së lashtë të thurjes me dorë, një metodë tradicionale e prodhimit të tekstitit, dhe fijet e përdorura janë vendore.

**N**dryshe nga Rugova, dizajnerja **Nadira Kika** gjen furnizim të tekstilit në Turqi, Dubai dhe Indi. “Çdoherë ka nevojë për përmirësim, ka nevojë për makina industriale të prodhimit, gjë që e lehtëson kohën e prodhimit. Kosova është në një vijë paralele me vendet e tjera sa i përket prodhimit në këtë industri, ka filluar të marrë primatin e Turqisë, ashtu si ka qenë më herët,” tha Kika.



**N**ë Kosovë janë shtuar brendet që krijojnë “fast fashion”, moda e shpejtë. Një nga brendet e njohura është “Drippin”.

Dizajnerja e brendit është **Jona Demi**, e cila furnizimin e gjen në Evropë dhe në Prishtinë. Për të Kosova nuk i përmbush të gjitha kushtet e cilësisë për prodhim dhe furnizim. “Kostot e prodhimit ndryshojnë, pasi ne furnizohemi vetëm me lëndën e parë (materialin), ndërsa i gjithë procesi i prodhimit realizohet nga ekipi ynë për të sjellë një produkt final”, shton Demi.

**D**isa kreatorë përdorin edhe metodën e riciklimit të materialeve, siç është **Zana Maxhuni**, për të cilën rikrijimi i materialeve ekzistuese dhe riciklimi i tyre janë e vetmja mundësi për të krijuar diçka unike. “Sa i përket riciklimit, nëse ne si dizajnerë duam ta ruajmë ambientin dhe, gjithashtu, duke e bërë këtë të krijojmë gjëra unike dhe interesante, është pak problematike, sepse te ne nuk kemi mjete adekuate për riciklimin e materialeve në mënyrë që prej këtij riciklimi të krijohet një material tjetër, për t’u shfrytëzuar më pas në një formë tjetër. Ndërsa rikrijimi është tjetër gjë, sepse nga ato materiale ose veshje ekzistuese ti vetëm i shndërron në forma dhe veshje të tjera,”



tha Maxhuni. Sipas dizajneres, kostoja e prodhimit është më e ulët në Kosovë sesa në vendet e tjera. “Ne në fushën e rrobaqepësisë/prodhimit kemi shumë gra dhe vajza të zonjat që e kryejnë këtë punë pa problem dhe unë mendoj që në vendin tonë duhet të ekzistojnë më shumë fabrika për prodhim dhe ato prodhime të eksportohen në vendet e jashtme. Gjithashtu, fuqia punëtore është më e lirë sesa në disa vende të tjera, duke përjashtuar Kinën dhe Indinë, sepse atje kostoja për prodhim është shumë e ulët dhe jashtë çdo norme njerëzore,” shton ajo.

Ky sektor ka një potencial të madh për zgjerimin e punësimit, qarkullimit dhe rritjen e eksporteve. Sipas një raporti, të krijuar në vitin 2019 nga “Kiesa” dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në Kosovë janë 111 ndërmarrje private të angazhuara në prodhimin e tekstilit, shumica e të cilave prodhojnë produkte për jashtë vendit.



# VESSHJA E RUGOVËS

**V**eshja e Rugovës është një nga elementet më të njohura të kulturës dhe traditës shqiptare. Ajo përfaqëson një kombinim të veçantë të ngjyrave, motiveve dhe ornamenteve që janë pasqyruar në veshjet tradicionale të kësaj treve. Disa nga karakteristikat kryesore të veshjes së Rugovës përfshijnë:

## 1. Për burrat:

- Plisi (kapuçi i bardhë), i cili simbolizon traditën shqiptare i mbështjellë me shallin e bardhë.
- Xhamadani ose jeleku me ornamente karakteristike.
- Pantallona të gjera të bardha, shpesh të quajtura tirq, të qëndisura me motive të zeza.
- Opingat, këpucë tradicionale të punuara me lëkurë.

## 2. Për gratë:

- Fustanellat ose fundet e gjera të bardha.
- Përparjet e qëndisura me motive të kuqe dhe të zeza, që shpesh simbolizojnë ngjyra tradicionale shqiptare.
- Shamitë e kokës, të qëndisura ose me motive të thjeshta, që mbulonin flokët.
- Ornamente të ndryshme si stolitë prej argjendi apo filigrani.

Ngjyrat kryesore në veshjen e Rugovës janë e bardha, e zeza dhe e kuaja, që përfaqësojnë pastërtinë, traditën dhe gjallërinë e kulturës. Ajo ka mbetur një simbol i fortë i identitetit kombëtar dhe përdoret shpesh në festivale kulturore, dasma, dhe raste të tjera të veçanta.

Dëshiron që të krijojë një ilustrim për veshjen tradicionale të Rugovës apo ndonjë element specifik?







## MIRËSEVINI | BIENVENIDOS | WILLKOMMEN

Restaurant ESQUINA ofron një meny të pasur dhe të shijshme me u shqime të freskëta dhe të zgjedhura me kujdes. Çdo pjatë e servuar në restorantin tonë është një kombinim i traditës dhe inovacionit të kuzhinës meksikane duke i shtuar elemente moderne. Atmosfera jonë e ngrohtë dhe mikpritëse është ideale për një darkë të paharruar, një festë familjare, shoqërie ose një takim biznesi. Ejani dhe na lejoni t'ju afrojmë një përjetim të veçantë. Në ESQUINA mikpritja jonë e veçantë dhe shijet e jashtëzakonshme do t'ju bëjnë të ndiheni si në shtëpi.

Ju mirëpresim!

Nehat Sabedini dhe Kreshnik Mulosmani

 E hënë - e diel: 10:00 - 00:00 h

 Chesterplatz 3, 79539 Lorrach, Gjermani

 +49 7621 6656050

 [info@esquina-loe.de](mailto:info@esquina-loe.de)

 [www.esquina-loe.de](http://www.esquina-loe.de)




**EINFACH  
LECKER**

# Bignine



 +49 7621 1687077

 Turmstraße 7, 79539 Lorrach, Germany



# TURIZMI FAMILJAR QË PO NDËRTOHET NË RUGOVË

**Njëra nga zonat më të bukura të Kosovës strehon bukuritë përrallore dhe mundësitë e turizmit në Kosovë.**

**D**relaj, Kuqishta, Boga dhe fshatrat e tjera të Rugovës janë në mesin e atraksioneve turistike të Kosovës. Bujtinat familjare të ndërtuara në zonë u ofrojnë turistëve hapësira të bollshme për pushim kualitativ dhe me çmime të lira. Rugova nuk ka shumë hotele të mëdha, por me çmime që sillen nga 50 deri në 70 euro nata pushuesit mund të marrin me qira shtëpi malore të banorëve, të cilat mundësojnë përjetimin e netëve të bukura në Grykën e Rugovës. Në shtëpitë prej druri pushuesit mund të shijojnë jetesën tradicionale dhe bukurinë e natyrës së kësaj zone. Peizazhi i Rugovës është i jashtëzakonshëm, me luginën e thellë, ujëvara, liqene dhe male që ofrojnë mundësi për aktivitete të ndryshme.

## **Disa atraksione kryesore për turizmin në Rugovë**

**Ujëvara e Bogës** - Një nga ujëvarat më të bukura në Kosovë, e vendosur në afërsi të fshatit Bogë. Është një pikë e njohur për turizmin, veçanërisht për ecje dhe foto.

**Lugina e Rugovës** - Lugina është një vend ideal për hiking dhe trekking, me peizazhe të pabesueshme dhe mundësi për të eksploruar natyrën.

**Malet e Rugovës** - Rugova është një rajon i njohur për mundësitë e ngjitjes malore dhe turizmit të aventurës. Malet janë të larta dhe të mbuluara me pyje dhe barishte, duke ofruar një peizazh të bukur.

**Fshatrat e Rugovës** - Vizita në fshatrat tradicionale të Rugovës mund të ofrojë një mundësi për të mësuar për kulturën dhe historinë e këtij rajoni, duke u njohur me mikpritjen e banorëve dhe ushqimin tradicional.

**Turizmi veror dhe dimëror** - Në dimër, Rugova ofron mundësi për skijim dhe aktivitete dimërore, ndërsa në verë mund të shijoni ecje, çiklizëm dhe piknik në natyrë.

**Via Ferata**  
Via Ferata është njëri nga



atraksionet e Rugovës. Vizitorët mund të udhëtojnë për kilometra në shkëmbinjtë e zonës për të shijuar bukuritë përrallore të zonës. Bashkë me Via Ferata, zona ka një zip line atraktive për pushuesit.

### **Vizitë liqenit**

Liqeni i Rugovës ndodhet në Luginën e Rugovës në Kosovë dhe është një liqen malor i mrekullueshëm. Ky liqen ka një lartësi rreth 1,500 metra mbi nivelin e detit dhe është i rrethuar nga male të larta dhe pyje të dendura, duke krijuar një peizazh shumë të bukur dhe të qetë.

Liqeni është formuar nga shkrirja e akullnajave gjatë mijëra viteve dhe është i njohur për ngjyrën e tij të kaltër-jeshile, e cila vjen nga përmbajtja minerale e ujit. Zona përreth liqenit është shumë popullore për aktivitete në natyrë, si ecje malore, not dhe kamping. Ka shtigje ecjeje që çojnë përmes Kanionit të Rugovës, duke ofruar pamje mahnitëse të



luginës, shkëmbinjve dhe ujëvarave. Nëse planifikoni ta vizitoni, është mirë të kontrolloni kushtet e motit dhe informacionin mbi shtigjet, pasi zona mund të jetë sfiduese për ata që nuk janë të zakonshëm me terrene malore.





# RRJEDHAT E LUMENJVE TË SHQIPËRISË KRIJOJNË PEIZAZHE MAGJEPSËSE

Në rrjedhat e tyre, lumenjtë e Shqipërisë krijojnë ujëvara dhe kanione, të cilat janë atraksion për t'u vizituar gjatë verës dhe dimrit. Kanionet dhe ujëvarat e famshme të vendit vizitohen çdo vit nga mijëra vizitorë, ndërsa në skajet e tyre janë ndërtuar komplekse turistike ku pushuesit mund të ushqehen dhe të çlodhen.



## Kanioni i Vjosës (Kanioni i Lengaricës)

– Ky kanion ndodhet në jug të Shqipërisë, afër qytetit të Përmetit. Është

një nga kanionet më të thella dhe më të bukura, me ujëra të kristalta dhe një natyrë të paprekur.



**Kanioni i Gajtanit** – Ky kanion ndodhet afër qytetit të Shkodrës dhe është i njohur për peizazhin e tij mahnitës dhe rrjedhën e ujit që

krijon një atmosferë shumë të qetë dhe piktoreske.



## Kanioni i Nezakjës

– Ky kanion ndodhet në jug të Shqipërisë, në afërsi të qytetit të Fierit. Pjesa më e bukur e këtij kanioni janë

natyra e paprekur dhe formacionet shkëmbore.

## Kanioni i Matit –

Ky kanion është i njohur për shtrirjen e tij dhe bukurinë që ofron, duke kaluar përmes një terreni malor tërheqës. Kanioni është i njohur për veçantitë natyrore dhe faunën e tij.



## Kanioni i Dajti

– Ky kanion ndodhet në afërsi të Tiranës, duke ofruar një pamje të mrekullueshme mbi qytetin dhe

rethinat. Gjatë verës, ky vend është një pikë shumë popullore për turistët që duan të shijojnë natyrën dhe ajrin e pastër.

**Shqipëria ka një pasuri të madhe ujëvarash, të cilat ofrojnë peizazhe mbresëlënëse dhe janë atraksione natyrore shumë të vizituara. Ja disa prej ujëvarave më të njohura dhe më të bukura në Shqipëri:**



**Ujëvara e Shën Mërisë (Ujëvara e Thethit)** – Ujëvara e Shën Mërisë ndodhet në fshatin Theth, në Alpet Shqiptare. Është një nga ujëvarat më të

njohura dhe më të bukura në Shqipëri, me ujë që bie nga një lartësi prej rreth 30 metrash. Rreth saj ka një pamje mahnitëse malore dhe është një destinacion i preferuar për turistët që e vizitojnë këtë zonë.

**Ujëvara e Bogës (Ujëvara e Bogs)**

– Ujëvara e Bogës ndodhet në një fshat malor në jugperëndim të Shqipërisë. Kjo ujëvarë është një atraksion natyror dhe është pjesë e një peizazhi mahnitës, ku uji bie nga shkëmbinjtë dhe krijon një ambient të qetë dhe të bukur.



**Ujëvara e Nivicës** – Kjo ujëvarë ndodhet në fshatin Nivicë, afër qytetit të Përmetit. Është një ujëvarë e lartë dhe shumë tërheqëse, me ujë

që rrjedh nga lartësia e malit dhe krijon një panoramë mbresëlënëse.



**Ujëvara e Grunasit**

– Ujëvara e Grunasit ndodhet në rrethin e Shkodrës dhe është e njohur për bukurinë e saj natyrore. Uji bie nga një lartësi prej

rreth 25 metrash dhe krijon një efekt shumë të bukur, sidomos në sezonin pranveror kur niveli i ujit është më i lartë.

**Ujëvara e Lëpushës**

– Ujëvara e Lëpushës ndodhet në një nga fshatrat e rajonit të Dukat, në jugperëndim të Shqipërisë. Ky është një destinacion



shumë i bukur për ata që duan të shijojnë natyrën dhe të zbulojnë ujëvara të panjohura nga shumica.



**Ujëvara e Komanit**

– Ujëvara e Komanit ndodhet pranë liqenit të Komanit në veri të Shqipërisë. Ky liqen është i njohur për ujërat e tij të pastra dhe për

peizazhin spektakolar malor që ofron. Ujëvarat që rrethojnë liqenin janë një pamje fantastike për ata që e vizitojnë këtë zonë.

**Ujëvara e Cakran**

– Ujëvara e Cakran ndodhet në jug të Shqipërisë, afër qytetit të Fierit. Ajo është një ujëvarë më e vogël, por shumë e bukur dhe e qetë, e rrethuar nga natyra dhe terreni malor.



# NDËRTIMET QË PO ZHVILLOJNË DURRËSIN DHE KAVAJËN

Kompania e ndërtimit “Bonita Konstruksion” është duke realizuar tri projekte të mëdha në zonën e Golemit dhe Kavajës.

Në tri komplekset “Viena”, “Bonita Luxury” dhe “Bonita Qerret” ofrohen rreth 1 mijë apartamente, të vendosura në zonat e pastra të Golemit dhe Qerretit.



**Kompleksi “Viena”** ndodhet në Golem dhe ofron një mundësi të shkëlqyer për investime në fushën e turizmit.



## MUNDËSITË PËR PAGESË ME KËSTE

Kompania ka garantuar një skemë të financimit, përmes së cilës blerësit nuk janë të obliguar të paguajnë tërë shumën në ditën e blerjes së apartamentit. Në negociatat me kompaninë, klientët mund të paguajnë për blerjen e apartamentit duke filluar nga 40% e vlerës së investimit. Në negociata me zyrën e shitjes për klientët që vendosin të kryejnë pagesën e plotë të apartamenteve në avancë.

## MUNDËSIA E QIRADHËNIES SË BANESËS SË BLERË

Në kompleksin “Bonita” investitori e ka paraparë ndërtimin e një hoteli të brendit “Bonita”. Blerësit e banesave do të kenë mundësi që në kohën kur nuk i shfrytëzojnë banesat t'i japin me qira për hotelin “Bonita” dhe klientët e tjerë. Ky sistem u garanton investitorëve kthim të investimit nëpërmjet qiradhënies, e cila në vitet e fundit në zonën e Qerretit është rritur shumë edhe në kërkesë, edhe në çmim.



**Kompleksi tjetër, “Bonita Luxury”, ndodhet në Golem, pranë bregut të detit.** Përveç apartamenteve për shitje, kompleksi përfshin edhe një park ujor (aqua park) dhe hapësira rekreative të veçanta.



#### **MUNDËSIA E ADAPTIMIT TË HAPËSIRAVE**

Objektet në ndërtim në kompleksin “Bonita” kanë mundësi të adaptimit të hapësirave për nevojat specifike të klientëve. Brenda mureve, kompania mund të krijojë ndërhyrje për të përshtatur kërkesat e klientëve, për të rritur apo zvogëluar hapësirat e dhomave. Bashkë me këto klientët, mund të vendosin të përdorin materiale specifike në renovimin e hapësirave të brendshme të objektit.



**Ndërsa kompleksi “Bonita Qerret” ndodhet në zonën ekskluzive të Qerretit dhe ofron rreth 500 apartamente të cilësisë së lartë.**



#### **INFORMACIONET PËR BLERËSIT**

“Bonita Konstruksion” ka prezantuar tashmë projektin para klientëve dhe të interesuarve.

Zyra e shitjeve ka lansuar edhe linjën e drejtpërdrejtë të kontaktit në telefon dhe në ËhatsApp, në numrin e telefonit **+355 69 238 6456 (direkt ose WhatsApp)**. Klientëve u rekomandohet vizitë në vendpunishten ku po ndërtohet objekti dhe vizitë në projektet e tjera të ndërtuara nga “Bonita Konstruksion”, në të cilat janë shitur qindra apartamente.



- 290+ Kanale • 30+ Liga sportive • Internet deri në 500Mbps • Digitalb
- BigBrother VIP Kosova • BigBrother VIP Albania • Kanalet e Cinestar

**Kujtesa** jote,  
përjetim i ri!

0800 400 40  
[www.kujtesa.com](http://www.kujtesa.com)



Jepni jetë kopshtit tuaj!

+ 383 49 777 406

[www.lulishtjalabi.com](http://www.lulishtjalabi.com)

Magjistranja Prishtinë-Ferizaj



# FROSTEA



**Frostea udhëton  
bashkë me ty!**



## MAKINAT NGA KOREJA VERIORE PO E “PUSHTOJNË” TREGUN E KOSOVËS

**Mbi 2 mijë makina nga Koreja e Jugut janë importuar në Kosovë gjatë periudhës ndërmjet viteve 2023 dhe 2024. Tregtarët e makinave, por edhe blerësit individualë, kanë arritur të gjejnë një treg më të lirë të makinave, i cili çdo ditë po eksplorohet gjithnjë e më shumë nga qytetarët e Kosovës.**

**K**oreja e Jugut ndodhet rreth 9 mijë kilometra larg Kosovës, apo katër herë më larg se Gjermania, por blerësit nga Kosova po blejnë makina të prodhuara në këtë shtet, si dhe makinat gjermane.

“Çmimet e shitjes atje janë shumë të ulëta, për shkak të politikave që ata kanë për makinat e reja dhe makinat elektrike.

Makinat me naftë, 10-vjeçare apo edhe më të reja, përpiqen t’i shesin për të blerë makina më të reja, elektrike”, thotë një nga tregtarët e makinave që importon nga ky shtet.

Prurjetimi prej 9 mijë kilometrash i makinave kryhet nga kompani të ndryshme, të cilat organizojnë fillimisht blerjen e makinave në ankande online për shitjen e tyre.

Visar Zejnullahu nga kompania Luxury Cars ka ndarë informacion

rreth importit të makinave nga Koreja.

“Në vitin 2022, ka filluar importi i makinave nga Koreja. Gjatë këtij viti janë importuar gjithsej 16 automjete. Në vitin 2023, importi është rritur ndjeshëm, duke arritur në 262 automjete. Ndërsa në vitin 2024, pritet të importohen 600 automjete” thotë Zejnullahu.

Ai tregon se Makinat e prodhuara në Kore janë plotësisht të njëjta me ato evropiane për nga cilësia dhe standardet teknike. “Çmimi më i ulët i këtyre makinave shpjegohet nga fokusi i prodhuesve koreanë te makinat elektrike, duke u bazuar në përpjekjet për mbrojtjen e mjedisit” rrëfen Zejnullahu. Ai tregon se Politikën mbështetëse të qeverisë koreane janë një faktor kyç në uljen e kostove. Për çdo makinë elektrike të shitur për 10,000 euro, qeveria shton një bonus prej 900



importuara nga kjo zonë nuk kanë nevojë për kontrole shtesë apo certifikata të veçanta importi. Procesi i regjistrimit është i ngjashëm me atë të makinave që importohen nga vendet e Bashkimit Evropian. Importuesit tregojnë se markat e makinave që importohen nga Koreja e Jugut janë, gjithashtu, brende botërore që janë të njohura dhe të preferuara në Kosovë dhe në Shqipëri, përfshirë markat si Mercedes, Volksëagen, Peugeot dhe makinat e prodhuara në vendet evropiane.

eurosh. Makinat elektrike përfitojnë një subvencion prej 25% nga qeveria. Gjithashtu, ato lirohen 100% nga të gjitha taksa

**“ Pazari në ankande është i thjeshtë dhe kryhet në mënyrë të sigurt, duke realizuar pagesa përmes transfertave bankare. Nga Koreja, makinat vendosen në anijet transportuese që i sjellin ato në Portin e Durrësit. Nga aty, makinat transportohen në tregun e Kosovës dhe pas procesit të zhdoganimit ato janë të gatshme për t'u përdorur në rrugët e vendit.**

Sipas standardeve, makinat e



DESIGN

REKLAMA 3D

Be Only Premium

DIGITAL PRINT

ADVERTISING

MATERIALE  
PROMOCIONALE

BRANDING

LED SCREEN

 **ZHAKIADVERTISING**



+383 (0)38 60 60 68  
+383 (0)45 87 87 87  
+383 (0)45 97 97 97

Highway Prishtina - Shkup 6-th km  
10000 Prishtinë, Kosovë  
info@zhakiadvertising.com  
www.zhakiadvertising.com

thirr.com

# INTERNETI MË I MIRË 5G PËR KOSOVË & EUROPË

AKTIVIZOJE eSIM ONLINE OSE TEK PIKA NË AEROPORT (TEK DALJA)

## PAKO EUROPA+

FUNKSIONON NË 80+ SHTETE



1GB

3<sup>49</sup>€

15 DITË

3GB

8<sup>49</sup>€

30 DITË

6GB

13<sup>99</sup>€

30 DITË

12GB

18<sup>99</sup>€

30 DITË

20GB

29<sup>99</sup>€

30 DITË

30GB

39<sup>99</sup>€

30 DITË

30GB

59<sup>99</sup>€

180 DITË

50GB

99<sup>99</sup>€

365 DITË

## Udhëto pa brenga me pakot PALIMIT

19<sup>99</sup>€

3 DITË

29<sup>99</sup>€

7 DITË

44<sup>99</sup>€

30 DITË



## KUJDESI FAMILJAR PËR NJOHJEN E GJUHËS SHQIPE NGA FËMIJËT SHQIPTARË NË DIASPORË

SHKRUAN NUHI GASHI

### Ja 10 fakte e të mira pse fëmija yt (në diasporë) duhet ta njohë gjuhën amtare (shqipe)

Fati e fakti se pothuaj gjysma e kombit shqiptar tashmë jeton jashtë hapësirës etnike shqiptare e vë atë para problemesh të shumta të zhvillimit arsimor e kulturor, të përshtatjes e të edukimit e ku ruajtja dhe zhvillimi i vlerave identitare shqiptare gjithnjë shfaqet si detyrë mbi detyrat. Natyrisht që moshë e re (fëmijët dhe të rinjtë), para së gjithash për shkak të ndjeshmërisë së saj të veçantë dhe peshës që ka më pas gjatë gjithë jetës (fundja në këtë moshë ndërtohet

personaliteti i njeriut), kërkon përgjegjësi, trajtim e përkrahje të veçantë. Sigurisht që shtrirja e kësaj përgjegjësie përfshin subjekte e faktorë të shumë, duke filluar nga prindi dhe familja e deri te shoqëria e shteti me institucionet e tij (shteti i prejardhjes ose shkurt Atdheu dhe shteti pritës ose 'Atdheu' a shteti tjetër). Në katalogun e pasur të bërësve identitarë, kjo përgjegjësi, ky trajtim, ky detyrim para së gjithash duhet të godasë me gjithë forcën që ka në nevojën e njohjes së gjuhës amtare (shqipe). Së këndejmi, ti, si prind, si qytetar, si patriot duhet të tregosh kujdes të veçantë ndaj kësaj çështjeje, duke i krijuar fëmijës

tënd rrethana sa më optimale për njohjen e gjuhës shqipe. Nga përvoja e ime në diasporë me qarqe e subjekte të ndryshme (shkollë, nxënës, mësues, prind,

shoqëri e faktor tjetër), zakonisht nuk kontestohet nevoja e njohjes së gjuhës amtare nga fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë, por kontestohet këmbëngulja për ta njohur atë që herët, ose arsyetohet me shkaqe e pasoja të paqena lënia ose shtyrja e kësaj njohje në një moshë të mëvonshme. Këtu sigurisht ka një det temash, por unë kësaj radhe, duke iu referuar gjithmonë rezultateve shkencore (gjuhësi, psikologji, psikolinguistikë, sociolinguistikë, antropologji, pedagogji ndërkulturore etj.), do të përpiqem të hedh më shumë dritë mbi atë se pse duhet të njihet gjuha amtare (shqipe) nga fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë në diasporë. Nëse problemin e shohim në raport me kushtet e zhvillimit normal arsimor e kulturor të fëmijës në Atdhe, atje (në Atdhe) njohja e gjuhës amtare në një njëfarë mënyre vetëkuptohet dhe ka një rrjedhë më ndryshe. Por në të dy rastet një gjë është e njëjtë: Ajo (gjuha) me varietetet e saj të pasura dialektore rrjedh pothuaj natyrshëm dhe zë fill në familje. Më pas, kryesisht përmes shkollës e me përkujdesje profesionale zhvillohet deri në nivel të standardit.

### Tash, t'i kthehemi pyetjes dhe t'i veçojmë, ndër shumë sosh, 10 të mira të kësaj njohjeje:

1. Për shqiptarët dhe identitetin e tyre gjuha shqipe është vetë identiteti kulturor e kombëtar, vetë shqiptaria, vetë të qenët shqiptar i

ndërgjegjshëm, vetë kujtesa kombëtare. Ajo përbën boshtin e lidhjen me të gjitha të mirat shpirtërore, historike, kulturore, trashëgiminë e pasur shqiptare etj.

2. Nëse në botën moderne sot flitet shumë për inteligjencën emocionale, njohja e gjuhës amtare përbën faktorin kyç për një zhvillim emocional të shëndetshëm, sepse, të themi, si zë i zemrës dhe i rrënjës që është, ajo komunikimit i jep ngjyrimë të tjera, më të ngrohta, më të afërta, më të dashura. Gjithë ato ndjenja e mendime rrjedhin brenda një harte emocionale të baraspeshuara, të cilat e ushqejnë edhe vetë procesin e njohjes.
3. Duke e njohur gjuhën amtare, e ke njohur më shumë prindin tënd, familjen tënde. Duke njohur njëkohësisht e do, e respekton dhe e çmon më shumë. Kjo marrëdhënie është e rëndësishme veçmas te rastet kur prindi për arsye të ndryshme nuk e njeh natyrshëm e mjaftueshëm gjuhën e vendit pritës. Në të gjitha rrethanat e njohjes ushqehet e pasurohet edhe një lloj stabiliteti emocional brenda familjes.
4. Njohja nënkupton e mundëson edhe shtrirjen e lidhjes e të komunikimit me pjesën e familjes në Atdhe, me të afërmit, me segmente të caktuara të shoqërisë. Pa dyshim, faktorë këta me ndikim të fuqishëm në zhvillimin identitar të fëmijës. Aq më tepër që kjo sot bëhet lehtë e suksesshëm falë mjeteve moderne të komunikimit, të cilat për fat të mirë në hapësirën shqiptare janë dallueshëm të përparuara
5. Duke e njohur gjuhën amtare, ti i ke dhënë ëmijës tënd siguri e vetëbesim e krenari në vlerat e tij burimore, të cilat të zhvilluara me kohë e bëjnë atë gjithnjë të ndjehet i përmbushur, i pavarur e sovran në vetëdijen e tij kulturore burimore. Të gjitha këto tipare kanë vlerë të veçantë në integrimin e tij pa omplekse në të gjitha hallkat e shoqërisë së vendit pritës, apo të themi edhe të 'Atdheut' të tij tjetër. Kjo është dera e madhe edhe kah një kompetencë e plotë ndërkulturore.
6. Duke e njohur gjuhën amtare ti i ke dhënë fëmijës aftësinë për të gjykuar më drejt me prirje të përhershme të zhvillimit të mendimit thjesht kritik. Posaçërisht për faktin se ai e ka mundësinë e ballafaqimit dhe të krahasimit të strukturave të ndryshme gjuhësore- kuptimore.



7. Duke e njohur gjuhën amtare ti i ke dhënë fëmijës mundësinë që të përfitojë në situata konkrete të komunikimit përmes procesit që e quajmë si bartje (transfer) të kompetencave, që bie se fëmija yt, nëse e njeh bukur gjuhën amtare, atëherë e ka të lehtë që shumë aftësi e vlera të tjera t'i bart në funksion të mësimit të gjuhës tjetër.
8. Njohja e gjuhës shqipe (amtare) nënkupton edhe një përparësi e lehtësi tjetër për njohje edhe të gjuhës a të gjuhëve të tjera (interaksioni gjuhësor) dhe njëkohësisht edhe sukses më të madh në shkollë. Mbase 'magjia' qëndron në vetë forcën e brendshme emocionale që mbrun në vete gjuha amtare.
9. Po ashtu, njohja e gjuhës amtare përbën edhe në përparësi e mundësi më shumë për karrierë më të suksesshme në të gjitha fushat. Bile, në karrierën biznesore, në kushtet aktuale, ku zhvillimi ekonomik i hapësirës shqiptare është gjithnjë e më i pranishëm (natyrisht edhe falë diasporës), kjo njohje bëhet më se e domosdoshme. P.sh. turizmi, si degë në kspanzion e me premtime të mëdha, përbën një fushë të pafundme. E kush më mirë e më shumë se shqiptari me kompetenca të plota (shumë) gjuhësore e (shumë) kulturore i del zot kësaj pune? Sigurisht, ai.
10. Njeriu si qenie shoqërore ka një nevojë të përhershme për thellimin e lidhjeve me komunitetin që i përket në të gjitha fushat. Edhe shqiptari vogël, kudo qoftë në botë, ka nevojë që ta bëjë të dukshme praninë e tij në të gjitha rrafshet e marrëdhënieve brenda përkatësisë e në përputhje me moshën e tij. Është gjuha amtare mjeti që ia mundëson natyrshëm e me dozën e krenarisë normale këtë.

Pra, prind i dashur, kujdes më shumë ndaj edukimit identitar të fëmijës. Veçmas ndaj bërësit kryesor të këtij identiteti-gjuhës shqipe.

# MËSIMI DHE TEKNOLOGJIA E SË ARDHMES

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë ka bërë që edhe nevoja për edukimin e gjeneratave të reja të jetë e ndërlidhur me trendet e fundit.

Shumë prindër sot janë të angazhuar-orientuar që fëmijët e tyre të ecin në hap me bashkëmoshatarët nga vendet e zhvilluara.

Një nga shkollat e cila ofron mundësi për fëmijët që kanë prirje për fushën e teknologjisë dhe robotikës është Akademia jCoders, e themeluar në vitin 2015-të.

Në këtë Akademi mund të ndjekin mësimet në disa drejtime që lidhen me teknologjinë-robotikën fëmijët që nga moshën 8 vjeçare.

Programi i jCoders është krijuar me qëllim që t'u ofroj nxënësve mjedise kreative për të mësuar konceptet më të reja teknologjike të përshtatshme për moshën e tyre.

“Nxënësit të cilët ndjekin të gjitha modulet të shtrira në programin 3 vjeçar arrijnë që të mësojnë një diversitet të teknologjive duke përfshirë kodimin e lojërave, aplikacioneve, krijimi në 3D, elektronikën dhe robotikën. Me këtë diversitet nxënësit fitojnë një bazë shumë stabile të të kuptuarit të teknologjisë, dhe arrijnë t'a shohin atë si vegël të cilën mund t'a përdorin për të krijuar”- thotë Arta Shehu Zaimi, anëtare e bordit në Akademia jCoders.

Sipas saj, duke zhvilluar planprograme, procese dhe teknologji, Akademia jCoders synon të përmirësojmë cilësinë e arsimit dhe të kontribuojë në ndërtimin e një gjenerate të re inovatorësh me një mendësi pozitive.

“Akademia jCoders është një institucion i cili ofron trajnime për nxënësit të moshave 8-18 në fushën e teknologjisë. jCoders është institucion i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe është i vetmi institucion që mban titullin “STEM CERTIFIED” në nivel ndërkombëtar nga institucioni amerikan COGNIA (më herët njohur si AdvanCED)“- tregon Shehu- Zaimi.

Sipas saj të gjitha modulet e jCoders janë pjesë e një plani më të madh dhe e çdo modul luan një rol në zhvillimin e nxënësve, ku nxënësi përveç që përvetëson një platformë të teknologjisë, gjithashtu i ka edhe trajnerët që fokusohen në zhvillimin e shkathtësive esenciale të shekullit 21. “Ne e marrim kohën tonë, jo vetëm për t'i vlerësuar shkathtësitë e nxënësve tanë por gjithashtu për t'iu ndihmuar atyre që të jenë versioni më i mirë i vetës”- thotë Shehu- Zaimi.

Ajo tregon se mësimet në këtë akademi nisin që nga niveli bazik i njohurive për përdorimin e kompjuterit e deri tek modulet e avancuara, përfshirë atë për Robotikën.

Ajo tregon se për të gjitha programet kjo Akademi ka një staf të përgatitur jashtëzakonisht kompetent për të bartur njohuritë tek fëmijët që ndjekin këto programe.

Sipas saj ajo çka është më e veçantë është se disa prej fëmijëve që kishin ndjekur trajnimet në jCoders tashmë janë trajnerë shumë të suksesshëm dhe shumë prej tyre edhe janë të punësuar në kompani të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Akademia jCoders ndodhet në 6 lokacione të Kosovës tri lokacione në Prishtinë, një në Pejë, një në Mitrovicë dhe një në Gjiilan.





## REZULTATET MËSIMORE TË FITUARA GJATË VITEVE

- Elementary Coder
- Përdorin kompjuterin në mënyrë efektive.
- Njohin arkitekturën hardverike të kompjuterit.
- Njohin komandat vizuale për programim të aplikacioneve/lojërave.
- Njohin logjikën e programimit në prapavijë të lojës/animacionit.
- Njohin elektricitetin, arkitekturën e pajisjeve të përditshme dhe krijimin e qarqeve elektrike për realizimin e ideve të tyre.
- Dizajnojnë në 3D konstrukte të objekteve të ndryshme.
- Krijojnë konstrukte fizike të projekteve në robotikë.



## ADVANCED CODER

- Dizajnojnë pamjen e aplikacioneve bazuar në rregullat e UI/UX.
- Krijojnë aplikacione mobile.
- Krijojnë moodboard dhe gjenerojnë paleta të ngjyrave.
- Krijojnë dizajne komplekse 2D.
- Krijojnë projekte duke manipuluar komponentet me anë të mikrokontrollerëve.
- Krijojnë qarqe të avancuara me aktuatorë dhe sensorë për të automatizuar proceset e përditshme.

## HULUMTOJNË NË MËNYRË MË EFEKTIVE.

- Mbrojnë mirë të dhënat e tyre në internet.
- Krijojnë lojëra me anë të programimit me blloqe.
- Zhvillojnë logjikë më komplekse në kod për ndërveprime të ndryshme.
- Krijojnë dhe aplikojnë komponente elektronike në qarqe elektrike duke krijuar pajisje të cilat ofrojnë zgjidhje për sfidat në përditshmëri.
- Njohin koncepte të matematikës të cilat ndërlidhen direkt me programim.
- Integrojnë aspekte të ndryshme si dizajni, programimi dhe elektronika në projektet e tyre.



# PRISHTINA QYTETI I MUZIKËS

**Prishtina, kryeqyteti i Kosovës, është një qytet që ka një skenë muzikore të gjallë dhe të pasur, ku mund të dëgjoni një shumëllojshmëri zhanresh dhe ritmesh që pasqyrojnë diversitetin kulturor dhe shijet e ndryshme të banorëve të saj. Nga rock, hip-hop, elektronika, deri tek muzika tradicionale, Prishtina ofron mundësi për çdo lloj shije muzikore.**

Vendet si “Defy Them” dhe “Kino ARMATA” janë të njohura për shfaqjet e muzikës live, duke ofruar një gamë të gjerë zhanresh, nga rock-u klasik, blues, jazz dhe muzika alternative. Këtu mund të gjeni grupe të rinjsh dhe artistë që performojnë për adhuruesit e muzikës së gjallë.

Në një intervistë për revistën “Kombëtare Uskana”, bashkëthemeluesi i “Defy Them” tregon se: “Vizioni fillestar për Defy Them ishte krijimi i një hapësire që i

jep muzikës dhe artistëve alternativë një platformë të denjë. Dëshëm të ndërtonim një vend ku talentet lokale dhe ndërkombëtare mund të bashkohen dhe të shprehen lirshëm, duke i dhënë qytetit një frymë të re kulturore dhe muzikore. Qëllimi është të promovojmë diversitetin muzikor, duke mbështetur artistë që përcjellin mesazhe të fuqishme përmes artit të tyre”.

**Fokusi i Defy Them është në muzikën**



“

**alternative, rock, metal, punk, indie dhe jazz dhe përzgjidhen me kujdes. “Defy Them shërben si një katalizator për zhvillimin e skenës muzikore dhe kulturore në Prishtinë. Duke ofruar një hapësirë për performanca, programe edukative, studio për incizime, hapësira për ushtrime, si dhe mundësi për bashkëpunime artistike, ne ndihmojmë artistët të rriten dhe të arrijnë audiencën të reja”, tha Uskana.**

Një nga sfidat më të mëdha që kanë hasur është balancimi mes pasionit dhe mundësive financiare. Po, ata janë gjithmonë në kërkim të mënyrave të reja për të rritur përvojën e publikut. Së shpejti, planifikojnë të shtojnë programe edukative, si punëtori dhe praktikë për muzicantët dhe menaxherët e grupeve përmes programit të tyre Music Incubator. Gjithashtu, po shqyrtojnë mundësinë e organizimit të festivaleve dhe bashkëpunimeve me artistë ndërkombëtarë për ta çuar Defy Them në një nivel tjetër.

“Defy Them dallon për fokusin e tij në autenticitet dhe përkushtimin ndaj muzikës alternative. Ne nuk

jemi vetëm një vend për performanca, jemi një platformë për artin, kulturën dhe bashkëpunimin. Atmosfera intime dhe e ngrohtë e hapësirës krijon një përvojë unike, ku çdo event dhe projekt merr formë në mënyrë të veçantë”, shton ai.

Prishtina gjithashtu ka një skenë të fortë elektronike dhe techno, ku vendet si “Servis Fantazia” dhe “Posht” janë të njohura për eventet e muzikës techno, house dhe drum & bass.

Një hapësirë tjetër e rëndësishme për kulturën dhe zhvillimin e muzikës është edhe “Kino ARMATA”, një kinema e pavarur që punon për promovimin e kulturës alternative dhe dialogut social. Kino ARMATA ofron një hapësirë për kineastët, artistët, muzikantët dhe shkrimtarët që shtyjnë kufijtë e zhanreve të tyre dhe sfidojnë kufizimet shoqërore. Synimi i Konferencës Muzikore të Prishtinës është të zhvillojë një kulturë të shëndetshme muzikore me vlera kulturore progresive,





subzhanri i servohet publikut.

Asdren Zogaj, producent i muzikës dhe kryesisht DJ i zhanrit Hip-Hop, thotë se: "Sikurse të gjitha zhanret, edhe hip hop/rap skena ka evoluar ndër vite. Tani kemi shumë subzhanre të muzikës hip hop, gjë që e bën edhe ndarjen e dëgjuesve në disa kategori. Hip hop skena në vendin tonë gjithmonë do ta ketë vendin e vet, pa marrë parasysh se çfarë subzhanri i servohet publikut. Prishtina dhe Kosova në përgjithësi e kanë pranuar këtë zhanër për një kohë të gjatë, prandaj edhe hip hop skena kosovare ka një rol të rëndësishëm në kulturën tonë

mbështetje të përpjekjeve artistike dhe muzikantëve të rinj. "PMC" është projekt i realizuar nga "Rave".

Rol të rëndësishëm në zhvillimin e muzikës në Kosovë ka edhe "Rave Travel", duke sjellë emra të njohur nga zhanre si muzika elektronike dhe jazz. Ben Klock dhe Elina Duni, Elif Çaglar, Jericho, janë vetëm disa nga emrat.

Tillt Radio gjithashtu është një komunitet online, Radio Station, Record Store & Online Magazine që transmeton 24/7 nga Prishtina. Muzika e përzgjedhur në Tillt i takon zhanrit indie, rock, dhe soft rock.

I njohur në kryeqytet është gjithashtu Rockuizin, një bar dhe restorant, i cili ka një fokus të veçantë në muzikën rock dhe alternativë. Ky vend është ideal për ata që duan të dëgjojnë muzikë të zgjedhur nga zhanre të ndryshme të rock-ut, duke përfshirë live performances, DJs dhe një atmosferë energjike. Rockuizin është një destinacion i preferuar për adhuruesit e muzikës rock, me një përzgjedhje të gjerë muzikore dhe ambiente që ofrojnë mundësi

për të kaluar kohë me miqtë, duke dëgjuar muzikë të mirë dhe duke shijuar pije dhe ushqime.

Trixi Bar është një tjetër vend që ka një program të ndryshëm muzikor, duke përfshirë hip hop dhe rap. Ky vend është i njohur për



tërheqjen e adhuruesve të muzikës urbane dhe rinisë që dëshiron të dëgjojë këngë nga artistë të njohur të hip hop-it.

Hip hop skena në vendin tonë gjithmonë do ta ketë vendin e vet, pa marrë parasysh se çfarë

muzikore. Hip hop ende dëgjohet në klubet kryesore të vendit, gjithashtu edhe në disa radio stacione të Kosovës". "Prishtinës dhe gjithë Kosovës sot i mungojnë listening bars, vende të vogla ku komunitetet e caktuara mund të dëgjojnë muzikë të mirëfilltë në volum të zërit normal dhe ku artistët e rinj mund të luajnë muzikën dhe shijen e tyre. Pastaj, mua çka më pengon pak është se një pjesë e qytetarëve nuk janë të hapur të eksplorojnë në muzikë. Bota e muzikës është aq e madhe sa që është gjynah të mos eksplorosh 'new sound'", shton Zogaj.

Për adhuruesit e muzikës tradicionale, disa lokale si "Sofra





Që nga paslufta organizohen disa festivale të muzikës klasike, si Kosova KamerFest, ReMusica, DAM Festival, dhe Chopin Piano Fest.

“Të rinjtë në Kosovë janë shumë të interesuar për muzikën klasike. Koncertet janë të mbushura me të rinj, dhe këtë e vënë re edhe dirigjentët dhe muzikantët ndërkombëtarë që vizitojnë Kosovën. Filharmonia e Kosovës ka organizuar ndër vite koncerte në sheshin e Prishtinës. Që nga viti 2019, koncertet në shesh janë kthyer në traditë dhe mbahen gjatë sezonit të verës”, thotë Noka.

Disa nga hapësirat ku

Restaurant” ofrojnë mundësinë për të dëgjuar muzikë live folklorike kosovare dhe ballkanike. Këtu mund të shijoni tingujt e fyellit, çiftelisë dhe instrumenteve tradicionale të rajonit.

Muzikën tradicionale kryesisht mund ta dëgjoni në restorante, vende familjare ku organizohen ahengje të ndryshme. Restoranti “Gjakova”, i frymëzuar nga traditat e qytetit të Gjakovës, ka performanca muzikore popullore që përfshijnë këngë dhe instrumente tradicionale shqiptare.

Për adhuruesit e muzikës klasike, vendi jonë po tregon çdo herë e më shumë një ngritje të interesimit, si nga organizatorët ashtu edhe nga qytetarët. Institucione si Teatri i Operës dhe Baletit dhe Filharmonia e Kosovës shpesh organizojnë koncerte të muzikës klasike.

“Skena e muzikës klasike që nga paslufta ka qenë gjithmonë në ngritje, fillimisht falë përkushtimit të komunitetit të muzikës klasike. Si hap i parë, ky komunitet u angazhua dhe themeloi Filharmoninë e Kosovës, e cila

vazhdon të jetë institucioni më i lartë i muzikës në vend dhe këtë vit shënon 25-vjetorin e themelimit. Po ashtu, ky vit shënon një tjetër përvjetor të rëndësishëm, pasi bëhen 50 vjet nga fillimi i jetës institucionale të muzikës simfonike



në Kosovë, me themelimin e Orkestrës së Radio Televizionit të Prishtinës në vitin 1975”, thotë për revistën Dardan Noka, ushtrues detyre i drejtorit në Filharmoninë e Kosovës.

organizohen koncertet e muzikës klasike në Prishtinë janë: Salla e Kuqe dhe Atelieja e Pallatit të Rinisë, Amfiteatri i Bibliotekës Universitare, Holli i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, Modelariumi i Fakultetit të Arkitekturës, dhe shpeshherë edhe hapësira të tjera, varësisht nga konceptet programore të koncerteve.

Prishtina ka një skenë muzikore të larmishme dhe dinamike që ofron mundësi për të gjithë ata që janë të interesuar në çdo zhanër të mundshëm. Nga rock-u dhe elektronika deri tek hip-hop dhe muzika tradicionale, ky qytet ka diçka për të gjithë.



# GATIMI I SHIJSHËM I PULËS SË RAHOVECIT



**N**jëra nga recetat e shijshme dhe tradicionale të përgatitjes së pulës në Kosovë është pula e Rahovecit.

"Pula me kos e Rahovecit" është një pjatë tradicionale shumë e shijshme! Zakonisht, përgatitet me mish pule të zbutur dhe të gatuar me kos të freskët, që shpesh kombinohet me erëza dhe hudhër për një aromë të pasur. Kosi i Rahovecit, i njohur për cilësinë dhe shijen e tij, është një përbërës kyç që i jep pjatës atë karakteristikën e veçantë.

*Receta tradicionale për gatimin e pulës me kos, sipas traditës së Rahovecit:*

## **PËRBËRËSIT:**

- 1 pulë e freskët (rreth 1.5 kg), e prerë në copa;
- 500 ml kos i freskët (preferohet kos i Rahovecit);
- 2-3 lugë gjelle gjalpë (ose vaj ulliri);
- 1 qepë e madhe, e grirë imët;
- 2 thelpinj hudhre, të grira imët;
- 1 lugë gjelle miell;
- 1 lugë çaji piper i zi;
- 1 lugë çaji spec i ëmbël;
- Kripë sipas shijes;
- Pak majdanoz i freskët, për zbukurim.

## **UDHËZIMET:**

Përgatitja e mishit të pulës:

- Pastroni pulën dhe priteni në copa. Marinoni me pak kripë dhe piper të zi.
- Në një tigan të madh, shkrini gjalpin dhe skuqni copat e pulës derisa të marrin një ngjyrë të artë në të gjitha anët. Hiqeni pulën dhe lëreni mënjanë.

## **PËRGATITJA E SALCËS ME KOS:**

- Në të njëjtin tigan, shtoni qepën e grirë dhe kaurdiseni derisa të zbutet dhe të bëhet transparente. Shtoni hudhrën dhe kaurdiseni për 1 minutë tjetër.
- Shtoni miellin dhe përziejeni mirë që të krijohet një masë e trashë dhe e butë.
- Ngadalë shtoni kosin, duke e përzier vazhdimisht që të mos krijohen kokrriza. Ulni zjarrin dhe përziejeni derisa salca të bëhet homogjene.

## **KOMBINIMI I PULËS DHE KOSIT:**

- Kthejeni copat e pulës në tigan dhe shtoni pak ujë ose lëng pule nëse salca duket shumë e trashë. Shtoni spec dhe rregulloni me kripë sipas shijes.
- Lëreni të ziejë në zjarr të ulët për rreth 30-40 minuta, derisa pula të jetë plotësisht e gatuar dhe salca të ketë një teksturë kremoze.

# NATURAL POOL & SPA



- 1 Pishinë e brendshme për të rritur Premium
- 1 Pishinë e brendshme për të rritur me qasje direkte në pishinën e jashtme ( e përshtatshme për çdo stinë )
- 1 Pishinë për fëmijë

- 1 Indoor swimming pool for adults Premium
- 1 Indoor swimming pool for adults with direct access into the outdoor swimming pool (available at any season)
- 1 Swimming pool for children



- 4 Sauna të jashtme finlandeze
- 4 Sauna të brendshme finlandeze
- 1 Saun e brendshme me rreze infra të kuqe
- 1 Saun e brendshme bimore

- 4 Outdoor Finnish saunas
- 4 Indoor Finnish Saunas
- 1 Indoor Infrared Sauna
- 1 Indoor Herbal Sauna




- 5 Jacuzzi të jashtëm me ujë të ngrohtë
- 3 Jacuzzi të jashtëm me ujë të ftohtë
- 3 Jacuzzi të brendshëm

- 5 Outdoor Jacuzzis with warm water
- 3 Outdoor Jacuzzis with cold water
- 3 Indoor Jacuzzis



- 1 Hammam (Banjë Turke) | 1 Hammam (Turkish Bath)



- 2 Solarium për rrezitje | 2 Tanning Bed Solarium



- Masazh | Massage

## RRETH NESH / ABOUT US

Natural Pool & SPA është një vend perfekt që ofron një përvojë unike për ata që kërkojnë qetësi dhe relaks! /

Natural Pool & SPA Is a perfect place that offers a unique experience for those looking peace and relaxation!

+383 48 473 473  
WWW.NATURAL-KS.COM

    
@NaturalPool&Spa

# E PËRHITURA

**N**a ishte një herë një vajzë e bukur, e cila jetonte së bashku me babanë e vet, pasi që nëna i kishte vdekur. Ajo shkonte për çdo ditë te varri i nënës dhe qante. Nuk kishte shokë të tjerë pos zogjve.

Një ditë babai i saj u martua me një grua, e cila i kishte dy vajza. Ato asnjëra nuk e donin të Përhiturën, ashtu siç ato e quanin, sepse ajo ishte më e bukur se ato. Ato ishin aq xhelozë sa që e detyronin në punë të ndryshme, po ashtu të veshë rroba të vjetra.

Kur binte nata dhe vajza kishte përfunduar punët e ditës, ajo ulej pranë hirit të zjarrit dhe qante, për këtë arsye edhe filluan ta quajnë e Përhitura.

Një ditë u përhap lajmi se mbreti do të bënte një festë, në të cilën të gjitha vajzat e mbretërisë do të ftoheshin. Puna ishte se princi donte të zgjidhte një vajzë që të fejohej më të. Kur dy motrat morën vesh se si ishte puna, u gëzuan shumë dhe nuk mund të mendonin asgjë tjetër përveçse çfarë fustani do të vishnin dhe si do t'i rregullonin flokët.

E Përhitura dhe ajo kishte dëshirë që të e takonte princin... Më në fund dhe dita e madhe arriti. Njerka dhe dy vajzat e saj morën rrugën për në kështjellë të mbretit erisa e Përhitura mbeti duke shikuar pas tyre. Kur ato humbën nga pamja, e Përhitura filloi të qajë me zë. Një zanë, që ishte pranë, e ndjeu atë, u bë e dukshme dhe tha:

- Ti dëshiron të shkosh në festë, apo jo?! Unë do të ndihmoj.

Po moj zanë, por unë nuk kam as fustan të vesh e as këpucë të mbath, që të mund të shkoj te princi...

- Shko në kopsht dhe këpute një kungull dhe ma sjell mua! Shko në tavan dhe gjeji gjashtë minakë dhe nën guri zbuloi gjashtë zhapinj...

E Përhitura pyeste veten se çfarë do zana me gjithë ato?! Sidoqoftë ajo bëri ashtu siç i tha zana, e cila me ndihmë të shkopit të saj magjik e shndërroi kungullin në karrocë të zbuluar me ari, minakën i shndërroi në kuaj, e nga zhapinjtë bëri gjashtë shërbëtorë për të Përhiturën. E më në fund lëvizi shkopin magjik dhe e veshi të Përhiturën me një fustan të bukur, punuar me ari e argjend, e në këmbë i mbathi një palë këpucë të bukura nga qelqi.

- Ngutu tani, i tha zana të Përhiturës. Por të kesh kujdes e të kthehesh para se të bjerë ora dymbëdhjetë. Pas orës së mesnatës ajo do të shndërrohej mu ashtu siç kishte qenë më parë, me rrobat të vjetra dhe këmbët zbatshur. E përhitura i premtoi zanës se do të kthehej para se ora të tregojë mesnatën.



Kur e Përhitura arriti në festën e mbretit dhe u paraqit në hyrje, salla ku vallëzohej u mbush me heshtje. Të gjithë qenë habitur me bukurinë e së Përhiturës. Princi kur e pa atë u drejtua menjëherë në drejtim të saj dhe tërë mbrëmjen nuk u largua nga e Përhitura. Mirëpo kur e Përhitura dëgjoi se ora filloi të shënojë mesnatën, iu kujtua se çka i kishte thënë zana. Ajo iu përkul princit dhe me hapa të shpejtë iku nga aty.

Ditën e ardhshme e Përhitura ishte prapë në festë dhe prapë princi e kaloi tërë mbrëmjen pranë të Përhiturës. Ditën e tretë e Përhitura ishte e habitur nga lumturia sa që nuk e dëgjoi orën, e cila bënte dymbëdhjetë. Në çastet e fundit ajo u kthjell dhe e kuptoi se duhet të ikë nga aty. Ajo nuk arriti të përshëndesë princin ashtu siç

duhej dhe ai nuk arriti të ndalë të Përhiturën të qëndrojë pranë tij. Duke vrapuar një këpucë ra nga këmba e saj dhe princi e mori atë dhe e afroi pranë zemrës. Princi ishte dashuruar në të Përhiturën dhe kishte vendosur të gjejë atë gjithsesi. Së shpejti u përhap lajmi se asaj që i përshtatet këpuca nga qelqi atë do ta fejojë princi.

Vajzat e njerkes u ngutën të provojnë këpucën, edhe pse e dinin se ajo nuk ishte e tyre.

Kur erdhi radha te vajzat e njerkes, u mundonin të shtinin këmbën në këpucë, por ajo ishte e pamundur dhe asnjëra nuk i përshtatej, ashtu sikur nuk i përshtatej asnjë vaje tjetër në mbretëri.

E Përhitura u afrua të mbathë këpucën dhe atë e bëri pa problem, si dhe njëkohësisht nxori këpucën tjetër qelqi nga xhepi i përparës dhe pasi e mbathi atë ajo u shndërrua në bukuroshen më të bukur në mbretëri.

Ditë më pas u bë dasmë e madhe: Princi dhe e Përhitura martoheshin.





# BASHKIMI BËN FUQINË

**H**eroi i kombit shqiptar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, pak kohë para se të vdiste, i mbledhi luftëtarët e tij për t'u dhënë një mesazh të rëndësishëm.

Ai i kërkoi trimat me emrin Gjon që të mernte një grumbull thuprash dhe t'i thyente së bashku.

Gjoni, që ishte një djalë muskuloz dhe i fuqishëm, i mori thuprat dhe u përpoq me gjithë forcën, por nuk arriti t'i thyente. Bashkë, thuprat ishin të pathyeshme.

Skënderbeu u kërkoi edhe trimave të tjerë të provonin t'i thyenin thuprat, por as tre nga trimat më të fuqishëm nuk patën sukses.

Afër shtratit të Skënderbeut ishte edhe djali i tij, Gjini. Ai i kërkoi Gjinit, që në atë kohë ishte ende i vogël dhe me pak fuqi, të provonte t'i thyente thuprat një nga një. Gjini i theu të gjitha.

"As më i fuqishmi nga ju" – tha Skënderbeu – "nuk mundi t'i thyente thuprat së bashku. Kurse Gjini, që është ende i vogël, i theu një nga një. Prandaj, qëndroni gjithmonë të bashkuar, sepse kështu edhe pa mua do të fitoni. Arbërisë nuk i kanë munguar kurrë trimat. Betohuni!"

## ***Trimat nxorën shpatat dhe thirrën:***

### ***"Betohe mi!"***

Luftërat për liri vazhduan edhe pas vdekjes së Skënderbeut. Gjergj Kastrioti shërbeu si frymëzim për luftërat për çlirimin e atdheut deri në ndërtimin e shtetit. Sot, shumë sheshe të vendit mbajnë emrin e tij në kujtim të veprës së tij.

# FABRIKA MODEL QË PUNËSON PERSONAT ME AFTËSI TË **KUFIZUARA**



Në afërsi të Lipjanit është ndërtuar një fabrikë e veçantë, e cila punëson vetëm persona me aftësi të kufizuara. Kjo fabrikë, e ndërtuar nga Fondacioni “Golden

**E**agle”, ka arritur të prodhojë produkte letre dhe të krijojë mundësi punësimi për këtë kategori të shoqërisë. Aktualisht, në prodhimin e letrës së markës “Freesia” janë të punësuar dhjetë persona.

Fabrika prodhon letër kuzhine dhe letër tualeti, të cilat ambalazhohen me karton dhe shiten në rreth 1400 pika në të gjithë Kosovën.



**Drejtori i fabrikës, Endrit Rexhaj, ka një histori personale frymëzuese. Ai ka humbur dorën e djathtë gjatë luftës së vitit 1999 dhe sot është menaxheri kryesor i kësaj fabrike. Sipas tij, ideja për themelimin e fabrikës erdhi si inspirim nga pronari i kompanisë “Frutex” dhe themeluesi i Fondacionit “Golden Eagle”, Shaqir Palushi.**





“

**“Pronari i ‘Frutex’-it, z. Shaqir Palushi, u inspirua nga historia ime, pasi kisha punuar për shtatë vjet në sektorin e IT-së në atë kompani”, thotë Rexhaj. Pas disa diskutimeve, u vendos që të ndërtohej fabrika, me qëllimin për të punësuar persona me aftësi të kufizuara.**



Pas një pune dyvjeçare, ideja u bë realitet dhe tani kompania i ka mbushur dy vjet që operon në treg. Fillimisht kishte vetëm dy punëtorë, ndërsa aktualisht ka dhjetë të punësuar. Rexhaj thekson se kapacitetet e fabrikës mund të arrijnë deri në 30 të punësuar dhe se ekzistojnë plane për zgjerimin e mëtejshëm të biznesit.

“Ne po punojmë për të zhvilluar ide të reja dhe për të zgjeruar ndikimin tonë në shoqëri. Për ta arritur këtë, është e rëndësishme që të ndihmohemi nga institucionet dhe qytetarët e Kosovës të blejnë produktet tona”, thekson Rexhaj. “Freesia Paper Factory” nuk është thjesht një fabrikë, por një komunitet që promovon barazinë, gjithëpërfshirjen dhe solidaritetin. Të gjitha të hyrat e saj përdoren për donacione dhe për të ndihmuar nevojat e ndryshme të shoqërisë.





# NJIHUNI ME MIC SOKOLIN

**M**ic Sokoli është një figurë heroike dhe simbol i sakrificës në historinë shqiptare. Ai është i njohur për aktin e tij të jashtëzakonshëm gjatë betejës së Slivovës kundër forcave osmane. Kur pa që topat e armikut po i dëmtonin rëndë radhët e para të luftëtarëve shqiptarë, ai sakrifikoi jetën e tij duke iu hedhur grykës së topit për të ndaluar sulmin dhe për të mbrojtur vendin. Ky veprim heroik e përjetësoi emrin e tij në historinë dhe folklorin shqiptar.

Mic Sokoli është përkujtuar me nderime në këngë popullore, poezi dhe tregime, si shembull i

dashurisë për lirinë dhe atdheun. Lufta e Slivovës, ku ai dha jetën, ishte pjesë e rezistencës së organizuar nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Kjo organizatë, e themeluar më 10 qershor 1878, luajti një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e territoreve shqiptare dhe në përpjekjet për autonomi kundër Perandorisë Osmane dhe planeve të fuqive të mëdha pas Kongresit të Berlinit.

Mic Sokoli mbetet një figurë frymëzuese dhe një model i sakrificës për idealet kombëtare, duke simbolizuar përkushtimin dhe dashurinë për lirinë e popullit shqiptar.



# TRANSPORT

## PËR MALLËRA DHE AUTOMOBILË

KOSOVË  
ZVICËR  
KOSOVË

### SHËRBIMET:

- ✓ Përvojë shumëvjeçare
- ✓ Profesionalizëm
- ✓ Siguri maksimale
- ✓ Kapacitete të mëdha
- ✓ Infrastrukturë moderne
- ✓ Çmime konkurruese



#### KONTAKT:

Zvicër: +41 76 700 2121, +41 79 640 1306  
Kosovë: +383 44 336 987, +383 49 227 200



POSSIBILITIES 4 PARTNERS

# Empowering Your Brand

with Tailored  
**Marketing Solutions**

## Our Services

- Marketing
- Digital Marketing
- Public Relations
- Production
- Web Development
- IT Solutions

## Shërbimet

- Marketing
- Marketing Dixhital
- Marrëdhënie me Publikun
- Produksion
- Zhvillim i Ueb-it
- Teknologji Informative

- TRANSFORMOJMË PREZENCËN TUAJ ONLINE
- REKLAMO BIZNESIN NË AEROPORTIN E PRISHTINËS ME OFERTËN MË TË MIRË
- REKLAMO BIZNESIN NË TELEVISIONE, RADIO DHE PORTALE ME OFERTË EKONOMIKE

CONNECT WITH US:



[www.pfp-ks.com](http://www.pfp-ks.com)



+383 43 899 331

Mirësevini në Hotel Bonita në Golem, Kavajë!

Hoteli me 5 yje ofron pishina të brendshme dhe të jashtme, SPA, qendër fitnessi, plazh privat dhe restorant me kuzhinë cilësore.

*Destinacioni ideal për pushime të paharrueshme!*

Për rezervimet tuaja kontaktoni në:

+355 69 822 9985

www.hotelbonita.al



# TRENDI MODERN I HOTELERISË

Mirësevini në Bonita Luxury Resort!

Një oaz luksi në Golem, Bonita ofron pushime të paharrueshme me AQUA PARK-un unik, katër pishina dhe plazhin rënor me shërbime të shkëlqyera në beach bar.

Relaks dhe argetim në një ambient modern dhe tërheqës!

- Akomodime luksoze
- Kuzhinë e klasit botëror
- Relaksohuni dhe rigjallërohuni

Kontakt:



+355 69 559 9916

www.hotelbonita.al





**DENTFIX**  
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



**Transform your confidence with our expert care!**

We specialize in advanced dentistry and precision hair transplant solutions, combining cutting-edge technology with personalized treatments. From radiant smiles to revitalized hair, we're here to help you look and feel as best as possible.




 @dentfix\_ks  
 +383 44 22 55 34  
 www.dentfix-ks.com  
 Ahmet Krasniqi Str. No 137,  
 Pristina, Kosovo

**Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI**



Part of DENTFIX GROUP



**CARE & HAIR FIX**  
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC